



ILD

INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

**PËR PUNËN E ZYRËS SË
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

**PËR PERIUDHËN
01.01.2021 – 31.12.2021**

PËRMBAJTJA

Mesazhi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	f 4
I. HYRJE	
1.1 Vizioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përmbushje të veprimtarisë.....	f 7
II. KUADRI LIGJOR QË RREGULLON ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË.....	
2.1 Referenca Ligjore.....	f 8
2.2 Akte të miratuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.....	f 9
III. VERIFIKIMI I ANKESAVE, HETIMI DISIPLINOR, DHE INSPEKTIMET.....	
3.1 Ankesa të depozituara pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.....	f 12
3.2 Arkivimi dhe verifikimi i ankesave	f 14
3.3 Ankime kundër vendimeve të arkivimit.....	f 15
3.4 Hetimet disiplinore.....	f 16
3.5 Kërkesat për procedim disiplinor dhe vendimet e Këshillave.....	f 17
3.6 Ecuria e trajtimit të ankesave nga fondi i ish- KLD-së.....	f 20
3.7 Të dhëna të përgjithshme mbi ankesat e regjistruara.....	f 21
3.7.1 Shkelje të pretenduara nga ankuesi.....	f 22
3.7.2 Ankesa të trajtuara sipas objektit të padisë.....	f 24
3.8 Inspektimet tematike.....	f 26
IV. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR	
4.1 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë-Këshilli i Lartë Gjyqësor/Këshilli i Lartë i Prokurorisë.....	f 28
4.2 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë-Prokurori i Përgjithshëm.....	f 29
4.3 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë-Ministria e Drejtësisë.....	f 30
4.4 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë-Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.....	f 31
4.5 Bashkëpunimi me aktorët e shoqërisë civile.....	f 31
4.6 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë.....	f 32
4.7 Zbatimi i rekomandimeve të instrumenteve ndërkombëtar, në kuadër të procesit për integrimin evropian.....	f 36
V. ORGANIZMI I BRENDSHËM.....	
5.1 Komandime nga KLGJ.....	f 41
5.2 Komandime nga KLP.....	f 42
5.3 Rekrutimi i inspektorëve jo-magjistratë.....	f 42
5.4 Zbatimi i ligjit “Për Shërbimin Civil” në kuadër të plotësimit dhe ngritjes së kapaciteteve	

të burimeve njerëzore.....	f 43
5.5 Veprimtari në kuadër të rritjes së kapaciteteve	f 44
VI. TË DHËNA MBI PROCESET GJYQËSORE KU INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ËSHTË PALË NDËRGJYQËSE.....	f 47
VII. NEVOJA PËR NDRYSHIM NË KUADRIN LIGJOR QË RREGULLON VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT.....	f 49
VIII. TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	f 53
8.1. Transparenca në fokus të veprimtarisë	f 53
8.2. Faqja e internetit si mënyrë komunikimi e institucionit.....	f 53
8.3. Pritja e qytetarëve në mjediset e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.....	f 55
8.4. E drejta e informimit.....	f 55
8.5. Mënyrat e komunikimit me publikun.....	f 56
8.6. Komunikimi me median si mënyrë për të arritur tek publiku.....	f 57
IX. PERFORMANCA FINANCIARE.....	f 58
X. PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE GJATË VITIT 2021.....	f 61
XI. PRIORITETET PËR VITIN 2022.....	f 61
XII. NIVELI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2021.....	f 63

Mesazhi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Të nderuar deputetë,

Eshtë hera e dytë që kam kënaqësinë të ndaj me Kuvendin përmes raportimit vjetor, ecurinë e punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, tani për vitin kalendarik 2021.

Në dy vite jetë të ILD-së, u mësua me vështirësitë e ngritjes dhe normimit të veprimtarisë së një institucioni krejtësisht të ri.

Na ka ndodhur, që më shpesh udhëhiqeshim nga sfidat, sesa t'i udhëhiqim ato!

Në dy vitet që lamë pas, bëmë gjithçka në emër të ndërtimit të praktikave të punës dhe të sigurimit të rezultatit maksimal, pa paragjykime dhe pa u lodhur, në misionin që i kemi vënë vetes.

Sot jemi të vetëdijshëm se duhet të nisim një kapitull të ri, sepse sfida më e madhe është ende aty! Është një sfidë e cila nuk kapërcehet dot vetëm, sepse është sfida e rikthimit të besimit tek Drejtësia.

Me këtë synim, siç do e shikoni në këtë raport, kemi patur në fokus qytetarët, orientimin e tyre tek procesi i ankimit në ILD, kur kanë pretendime për gjyqtarë e prokurorë. Për mua si Inspektor i Lartë i Drejtësisë, besimi në drejtësi lexohet sidomos kur i drejtohesh institucioneve dhe numri i ankesave në rritje pranë institucionit tonë, e tregon këtë.

4127 është totali i ankesave të administruara në ILD për vitin 2021. Një shifër impresionuese, që përbëhet nga stoku i trashëguar nga institucione të tjera dhe ankesa të reja të ardhura direkt në ILD. Për trajtimin e stokut të trashëguar, po punohet sipas një metodologjie, që ka prioritet shmangien e kulturës së pandëshkueshmërisë dhe harresës, përmes vendosjes në prioritet trajtimi, të ankesave dhe praktikave që janë brenda afatit 5 vjeçar të parashkrimit dhe atyre që kanë si subjekt magjistratët në detyrë. Natyrisht, puna vijon edhe me trajtimin e ankesave të reja, atyre të ardhura direkt në ILD.

I gjithë ky proces realizohet me vetëm 8 Inspektorë, nga 1 që kishim në vitin e parë të punës, por ende larg numrit të nevojshëm për të përballuar vëllimin e madh të punës. Plotësimi i kapaciteteve të hetimit mbetet një sfidë edhe në vazhdim, ndërsa ILD do bëjë pjesën e vet përmes rekrutimit të inspektorëve jo magjistratë.

Procedimi disiplinor është momenti final i punës, të cilit i kushtohet vëmendje e posaçme sepse nuk ka si qëllim parësor thjesht ndëshkimin e magjistratëve, por edhe edukimin e tyre

mbi rëndësinë që ka profesionalizmi e integriteti i magistratit, për besimin e publikut tek drejtësia.

Vetëm gjatë vitit 2021 janë 22 vendime për fillimin e hetimit disiplinor të miratuara nga ILD për 31 subjekte të hetimit disiplinor. Nga këto, 17 raste kanë shkuar për procedim disiplinor në Këshilla, ndërsa për 4 janë mbyllur hetimet. Nga 17 kërkesa për procedim disiplinor, 10 janë hetim me iniciativë nga Inspektori i Lartë dhe 7 janë rezultat i hetimit të ankesave të depozituara. Vetë inspektimet tematike kanë prodhuar 3 procedime disiplinore, 2 prej të cilave gjatë vitit 2020 dhe 1 gjatë vitit 2021. Masat e kërkuara për gjyqtarët e prokurorët e proceduar shkojnë nga vërejtje konfidenciale deri në shkarkim nga detyra. Nga 17 kërkesat për procedim të përcjella në Këshilla, asnjë kërkesë nuk është rrëzuar, dhe vetëm për 2 kërkesa është vendosur një masë tjetër disiplinore, meritë edhe e punës skrupuloze të ekipit të Inspektorëve të Zyrës së ILD-së, pavarësisht mungesës së 18 inspektorëve dhe ngarkesës së 8 Inspektorëve në detyrë.

Viti 2021 është shenjuar për ILD-në nga rritja e bashkëpunimit me aktorë kombëtarë, ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile, e cila është një monitoruese nga afër e punës së ILD-së. Bashkëpunimi me KLGJ-në e KLP-në ka qenë i rëndësishëm në koordinimin e standardeve uniforme për garantimin e një procesi të rregullt disiplinor e në respekt të pavarësisë së magistratëve, njëlloj edhe shkëmbimi i informacionit ndërinstitucional.

Duke qenë një institucion krejt i ri, ILD ka patur vëmendje të shtuar për ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve profesionale të hetimit, përmes shkëmbimit të praktikave më të mira në lidhje me procedurat e hetimit të shkeljeve disiplinore ndaj magistratëve. E kemi nisur këtë rrugëtim me miq të mirë, partnerë ndërkombëtarë nga EURALIUS e OPDAT, tek CEPEJ e deri tek Rrjeti European i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë, ku tashmë Inspektori i Lartë i Drejtësisë mban statusin e vëzhguesit, në një Rrjet ku anëtarët janë vetëm nga vende të Bashkimit European.

Gjatë vitit 2021 ILD i ka kushtuar vëmendje të posaçme dhe ka përmbushur pjesën më të madhe të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit, miratuar më 03.06.2020, me gjithë vështirësitë subjektive me të cilat është përballur.

Me gjithë sfidat, transparencën me publikun e konsiderojmë pikë të fortë të institucionit, pasi ILD e sheh marrëdhënien me publikun si një nga mënyrat më efektive, jo vetëm për të garantuar besimin e qytetarëve tek institucioni në veçanti, por edhe tek drejtësia në përgjithësi. Ishte pikërisht kjo fryma me të cilën u konceptua reforma në drejtësi dhe ILD në këto dy vite jetë po luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, përmes rezultateve të matshme.

Padyshim, sa i rëndësishëm është e drejta e shoqërisë dhe interesimi i saj se si administrohet drejtësia nga organet gjyqësore, sa i rëndësishëm është reagimi i institucioneve publike dhe i pushteteve të tjera për të parë dhe raportuar shkeljet e gjyqtareve dhe prokuroreve, po aq e

rëndësishme është edhe ndarja e pushteteve dhe pavarësia e gjyqtareve. Pavarësia e sistemit gjyqësor nuk është qëllim në vetvete, nuk është mburojë e luks për papërgjegjshmërinë e gjyqtarëve, por mbështetja për forcimin e paanshmërisë së tyre, është garanci se barazia para ligjit nuk do mbetet vetëm një parim në letër.

Në të njëjtën kohë, nevoja e garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor nuk do të thotë se ky pushtet është i mbyllur dhe nuk i nënshtrohet kontrollit. Por, do të thotë që organet e pushtetit gjyqësor duhet të jenë objekt kontrolli nga ana e organeve të tjera publike, si dhe duhet të lejojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe të jenë të përgjegjshëm dhe llogaridhënës ndaj tyre.

Institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si organ kushtetues, është mbartës i këtyre garancive kushtetuese. ILD ka për qëllim ushtrimin e të gjitha mjeteve apo mekanizmave që bëjnë të mundur balancimin dhe vendosjen e një ekuilibri të qartë ndërmjet ushtrimit të misionit dhe kompetencave të tij kushtetuese, organeve të pushtetit gjyqësor, si dhe organeve të tjera publike.

Realizimi konkret i këtyre parimeve në praktikë kërkon kohë, pasi jetësimi i këtyre vlerave të rëndësishme kushtetuese nuk ndodh në një kohë të shkurtër. Mund të ndodhë që këto parime të tingëllojnë dhe të lodhshme, pasi sistemi sot ka nevoja që nuk të japin kohe për të folur për to. Por unë jam i bindur se ushtrimi i çdo kompetence dhe ndërhyrjeje në punën e sistemit gjyqësor duhet në thelb të jetë i tillë që të garantojë ndarjen dhe balancimin e pushteteve, të garantojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe interesin e shoqërisë për administrimin e drejtësisë. Duke marrë këtë si qendër, në kuptimin real të fjalës dhe jo thjesht deklarativ, gjërat bëhen me të lehta, me të kuptueshme dhe zgjidhjet vijnë shumë më normalisht, pasi do të jenë të zhveshura nga subjektivizmi dhe nxehtësia e momentit.

Këtë filozofi do gjeni në veprimtarinë e ILD-së, e përmbledhur në raportin vjetor për vitin 2021, i paraqitur para jush!

I. HYRJE

1.1 Vizioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përmbushje të veprimtarisë

Vizioni i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, udhëhiqet nga parimet dhe vlerat e sistemeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, të tilla si ushtrimi i veprimtarisë në mënyrë të pavarur ndaj çdo lloj ndikimi duke iu nënshtuar vetëm Kushtetutës dhe kompetencave të dhëna me ligj; ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë të paanshme, të përgjegjshme, llogaridhënëse, me integritet të lartë moral dhe profesional në të gjitha nivelet strukturore, me efikasitet dhe profesionalizëm, të besueshme, transparente dhe të aksesueshme prej publikut, si dhe bashkëpunuese në nivel institucional.

Nën dritën e vizionit të veprimtarisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, drejton punën përmes katër objektivave të rëndësishëm:

- Fuqizimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesionale;
- Zhvillimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standardet ndërkombëtare.
- Pjesëmarrje aktive në proceset e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.
- Rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në Institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Për qëllime të zbatimit në praktikë të objektivave të punës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka propozuar strukturën organizative të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, e cila është konceptuar për të funksionuar në respektim të parimeve të hierarkisë; llogaridhënies; ligjshmërisë; efektivitetit; paanësisë dhe mos diskriminimit si dhe të bashkëpunimit, në përmbushjen e misioni Kushtetues e ligjor për të arritur objektivat e sipërpërmendura.

II. KUADRI LIGJOR QË RREGULLON ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

2.1 Referenca Ligjore

Reforma në Drejtësi, u konceptua dhe u vu në zbatim, në emër të kthimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Korniza e re kushtetuese dhe më pas lista e akteve ligjore për reformimin e sistemit të drejtësisë, ndër të tjera parashikoi organizimin dhe funksionimin e të gjitha organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë e midis tyre edhe Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ngritja e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, (ILD), përmbylli skemën e organeve të reja të sistemit të drejtësisë, të dalë nga Reforma në Drejtësi, duke i atribuar kompetenca dhe përgjegjësi Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

- për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve dhe fillimin e procedurave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj si dhe,
- për inspektimin institucional të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë.

Dispozitat organike për kryerjen e funksioneve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, statusin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe statusin e inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, parashikohen në Kreun IV, nenet 193-215 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë rregullohet nga:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Vendim nr. 536, datë 25.7.2019, i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo-magjistratë për pozicionin e inspektorit”;
- Vendimi nr. 28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mbështetet midis të tjerash në:

- Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;

- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”;
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar,
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligjin për buxhetin vjetor;
- Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”;
- Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
- Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”;
- Vendimit nr. 972, datë 02.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin të kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”;
- Vendimit nr. 971, datë 02.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për politikën e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit, për sistemin e drejtësisë”;
- Vendimit nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabinetëve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme”.

2.2 Akte të miratuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Në funksion të zbatimit të kompetencave ligjore, për sa i përket akteve të miratuara, janë hartuar dhe miratuar në total 33 urdhra të përgjithshëm me karakter administrativ që kanë të bëjnë me çështje të organizimit dhe funksionimit, menaxhimit dhe kontrollit financiar, sinjalizimit, dhe sigurinë e të dhënave dhe informacionit¹.

Krahas urdhrave të përgjithshëm, janë hartuar edhe 7 vendime, 1 vendim i cili përcakton

¹ Urdhrat janë të aksesueshëm në linkun: <https://ild.al/sq/legjislacion/akte/>

procedurën dhe rregullat e zbatueshme nga Komisioni i Emërimit dhe Vlerësimit, për vlerësimin etik dhe profesional të performancës së inspektorëve, 2 prej të cilave kanë të bëjnë me inspektimet tematike dhe 4 vendime ndryshuese në funksion të miradministrimit të proceseve inspektuese.

Sa i takon urdhrave të përgjithshëm administrativë, ndër më të rëndësishmet, rendisim sipas kategorive:

I - Organizim dhe funksionim:

1. Urdhër nr. 14, datë 27.01.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për mënyrën e raportimit dhe monitorimit të planit strategjik dhe planit të veprimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
2. Vendim nr. 18/1, datë 25.06.2020, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve të punës dhe kërkesave të pozicioneve të punës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar²;
3. Urdhër nr. 119, datë 12.07.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
4. Urdhër nr. 127, datë 10.09.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për caktimin e tarifave për shërbimin e dhënies së informacionit ose dokumentacionit me kërkesë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
5. Urdhër nr. 137/1, datë 15.11.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e listës së dokumenteve me afatet e ruajtjes për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

II - Menaxhimi dhe kontrollin financiar:

1. Urdhër nr. 96, datë 01.06.2021 “Për miratimin e proceseve të punës”;
2. Urdhër nr. 144, datë 03.11.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik”;
3. Urdhër nr. 160, datë 13.12.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores së menaxhimit të aktiveve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
4. Urdhër, nr. 168, datë 29.12.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e gjurmëve standarde të auditimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

III- Sinjalizimi:

1. Urdhër nr. 103, datë 14.06.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

² Ndryshim i miratuar gjatë vitit 2021, me vendimin nr. 62, datë 22.12.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për një ndryshim në vendimin nr. 18/1, datë 25.06.2020 “Për miratimin e kriterëve të punës dhe kërkesave të pozicioneve të punës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar”.

2. Urdhër nr. 102, datë 14.06.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores për hetimin administrativ të kërkesës për sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

IV- Mbrojtja e të dhënave dhe siguria e informacionit:

1. Urdhër nr. 140, datë 18.10.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
2. Urdhër nr. 163, datë 22.12.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores mbi parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Ndërsa në lidhje me veprimtarinë inspektuese, ndër më kryesoret renditen si më poshtë:

1. Vendim nr. 38, datë 08.06.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e procedurave dhe rregullave të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve”;
2. Vendim nr. 37, datë 01.06.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar”;
3. Vendim nr. 47, datë 15.07.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: “Respektimi i kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal për veprën penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, i ndryshuar.

Në zbatim të ligjit dhe në plotësim të rekomandimeve të rezolutës së datës 03.06.2021, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2020 (shkurt-dhjetor)”, vëmë në dijeni se, nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë në faza të ndryshme hartimi këto projekt akte:

- “Për miratimin e rregullave të hollësishme për administrimin e sistemit të brendshëm të çështjeve”;
- “Për hartimin e rregullores për trajtimin e ankesave”;
- “Për përcaktimin e metodologjisë për inspektimin”.

Aktet nënligjore me karakter rregullues të miratuara nga ILD-ja gjenden të publikuara në faqen zyrtare dhe të aksesueshme në linkun: <https://ild.al/sq/legjislacion/akte/>

III. VERIFIKIMI I ANKESAVE, HETIMI DISIPLINOR DHE INSPEKTIMET

3.1 Ankesa të depozituara pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 194 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Referuar veprimtarisë një vjeçare të punës, në funksion të përmbushjes së parashikimeve të mësipërme ligjore, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, numri i ankesave të paraqitura gjatë periudhës janar – dhjetor 2021, ka qenë i lartë. Numri i lartë është tregues për besimin që kanë qytetarët tek institucioni, sepse i drejtohen masivisht. Çdo ankesë ka një ecuri të përcaktuar ligjërish, që nis me shqyrtimin fillestar, verifikimin e më pas hetimin ose arkivimin, ecuri që kërkon kohë dhe kapacitet dhe për periudhën e këtij raportimit janë 1719 ankesa të shqyrtuara.

Gjatë këtij viti janë depozituar 1257 ankesa të reja, të ndara këto sipas subjekteve ankuese rezulton:

- 1210 ankesa të depozituara nga persona fizikë ose individë;
- 28 ankesa të depozituara nga organe publike;
- 12 ankesa të depozituara nga organizata të shoqërisë civile;
- 7 ankesa të depozituara nga media.

Duke marrë në konsideratë se me raportin e vitit 2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka mbyllur vitin me 2870 ankesa në proces, shqyrtimi i të cilave ka vijuar edhe gjatë vitit 2021, si shtesë ndaj numrit prej 1257 ankesave të depozituara për vitin 2021, totali i ankesave që kanë qenë objekt shqyrtimi është 4127 ankesa. Nga 4127, janë shqyrtuar 1719 ankesa, 427 prej të cilave janë pjesë e fondit të mbartur të ish- KLD-së apo të atyre të grumbulluara gjatë periudhës tranzitore deri në ngritjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndërsa 1292 rezultojnë të jenë trajtuar nga ankesat e depozituara pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në ushtrim të kompetencave Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shqyrtuar 1719 ankesa, nga numri totali prej 4127 ankesave. Rezultati i shqyrtimit të ankesave është:

- 990 vendime për arkivimin e 1433 ankesave;
- 197 vendime për verifikimin e 270 ankesave, të cilat do të vijonë për vitin 2022;
- 22 vendime për fillimin e hetimit disiplinor për 31 subjekte të hetimit disiplinor;
- 17 kërkesa për procedim disiplinor pranë Këshillave.

Sipas të dhënave të ecurisë së shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave, viti 2021 mbyllet me

2678³ ankesa në proces, që do të mbarten për trajtim në vitin 2022, 1677 prej tyre janë pjesë e fondit të kaluar nga ish-KLD-ja apo të atyre të grumbulluara gjatë periudhës tranzitore deri në ngritjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për verifikimin e ankesave ose hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj subjekteve të hetimit disiplinor, gjatë vitit 2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është vënë në lëvizje bazuar në:

- a) ankimin me shkrim të çdo personi fizik, juridik ose organi publik të interesuar;
- b) ankimin me shkrim të Ministrit të Drejtësisë;
- c) ankimin me shkrim të Prokurorit të Përgjithshëm Drejtësisë;
- ç) ankimin me shkrim të secilit anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- d) ankimin me shkrim nga kryetari i gjykatës ku punon gjyqtari që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore;
- dh) ankimin me shkrim nga drejtuesi i zyrës së prokurorisë ku punon prokurori që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore.

Kjo praktikë e ndjekur deri tani nuk reflekton plotësisht dispozitat që parashikojnë jo vetëm të drejta, por edhe detyrime edhe përgjegjësi dhe kompetenca të posaçme të Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm si dhe Këshillave, kjo pasi nga ana e këtyre organeve këto praktika janë konsideruar kryesisht dhe janë trajtuar si ankime edhe ankesa apo letra të mbërritura në adresë të tyre nga institucione apo shtetas dhe që thjesht janë përcjellë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresë përcjellëse.

Në funksion të ngritjes dhe konsolidimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe në emër të bashkëpunimit institucional, Zyra e ILD gjatë dy viteve të para ka qenë më shumë e fokusuar tek trajtimi i ankesave si dhe tek orientimi dhe edukimi i shtetasve. Formulimi i vendimeve ka synuar jo vetëm dhe thjesht analizën e ankesave, verifikimin e fakteve dhe praktikave, por shpesh nëpërmjet tyre, është synuar sqarimi, informimi dhe edukimi i ankuesve me dispozitat ligjore duke përfshirë interpretimin dhe leximin e drejtë të tyre.

Për këto arsye, institucioneve të cituara më lart ju është lënë një kohë tjetër për t'i ndërgjegjësuar dhe për të ndërtuar raporte korrekte dhe komunikim institucional në kufijtë e ligjit dhe sipas procedurave dhe përgjegjësive të parashikuara nga ligjet dhe dispozitat që rregullojnë veprimtarinë e secilit institucion. Shqyrtimi i praktikave të përcjella nga institucionet e sipërcituara, ka nxjerrë nevojën e shpjegimit dhe identifikimit të qartë të kompetencave që secili prej atyre institucioneve ka: (i) në raport me dispozitat që përcaktojnë detyrimet e tyre të drejtpërdrejta ndaj magistratëve në përgjithësi; dhe (ii) në raport me dispozitat që parashikojnë mënyrën, formën dhe kompetencën në rastet kur mund dhe duhet t'i drejtohen Zyrës së ILD-së me ankesë për shkelje disiplinore ndaj magistratëve që janë subjekte të hetimit disiplinor në veçanti.

³ Për 270 prej tyre, gjatë periudhës së raportimit rezultojnë të jenë në verifikim dhe rezultatet do të jepen në raportin pasardhës,

Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk inkurajon vijimin e përdorimit të mediave dhe drejtimin e ankesave nëpërmjet thirrjeve të tilla publike. Gjatë vitit 2021, ka pasur raste kur titullarë të institucioneve qendrore, i janë drejtuar me thirrje publike Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për nisjen kryesisht të hetimeve disiplinore, për raste që në vlerësimin e tyre përbënin raste flagrante të shkeljes së ligjit dhe dispozitave të caktuara. Ndërkohë konstatohet që edhe nga ana e institucioneve publike, pavarësisht ekspertizës dhe pranisë së strukturave të posaçme të kualifikuara në fushën e së drejtës, referimi i pretendimeve apo rasteve lidhur me shkelje disiplinore të magjistratëve nuk janë të argumentura apo të mbështetura me dokumentacionin përkatës. Referimi i rasteve nga ana e institucioneve publike nuk është kryer në kuadër të një vlerësimi të të gjithë informacionit të siguruar, në raport me disponimet ligjore në fuqi, si dhe në kuadër të një analize të mbështetur në të dhëna të besueshme se magjistrati ka kryer shkelje disiplinore.

3.2 Arkivimi dhe verifikimi i ankesave

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bazë të nenit 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme, sipas kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të paragrafit 1, të nenit 120, të ligjit nr. 96/2016. Gjatë fazës së shqyrtimit fillestar, verifikohet plotësimi i kriterëve të pranueshmërisë dhe brenda tre muajve nga depozitimi i ankesës vendos për arkivimin e ankesës, nëse një ose më shumë nga kriteret e pranueshmërisë së ankesës nuk përmbushen.

Sipas neni 122, të ligjit nr. 96/2016, për ankesën që nuk ka informacion të qartë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë verifikon nëse ka fakte të mjaftueshme që justifikojnë fillimin e hetimit, duke:

- kërkuar nga ankuesi dokumente dhe shpjegime shtesë për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar;
- marrë çdo informacion tjetër nga këshilli, gjykata ose prokuroria përkatëse.

Në përmbushje të këtyre parashikimeve ligjore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shqyrtuar 1719 ankesa, për të cilat ka miratuar 990 vendime për arkivim, prej të cilave 785 vendime janë marrë pas shqyrtimit fillestar, dhe 205 vendime arkivimi janë marrë pasi në përfundim të verifikimit të ankesës, është konstatuar se nuk ka fakte të mjaftueshme për të filluar fillimin. Ndërsa për 197 vendime për verifikimin e ankesave, gjatë periudhës së raportimit, shqyrtimi i tyre vijon të mbetet në proces, të dhënat e të cilave do të përditësohen në raportin vjetor pasardhës.

Nga shqyrtimi i ankesave të depozituara, për 90 prej rasteve ka rezultuar se një ankues ka paraqitur më shumë se një ankesë për të njëjtat fakte apo për të njëjtin magjistrat. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për këto raste ka vendosur bashkimin e ankesave.

Nisur nga shqyrtimi i ankesave, rezulton se problematikat apo pretendimet e ngritura më së shumti nga ankuesit ndahen si më poshtë:

- Ankesa ndaj vendimmarrjeve të padrejta të magjistratëve gjatë shqyrtimit të çështjeve;
- Pretendime për zvarritje të gjyqimit nga ana e magjistratëve;
- Shkelje procedurale nga ana e magjistratëve;

Nga analizimi i fakteve, ligjit dhe arsytimit të dhënë në vendim, ka rezultuar se shkaqet kryesore për arkivimin e ankesave të depozituara, janë:

- Shkelja e pretenduar nuk parashikohej si shkelje disiplinore nga ligji në kohën kur ka ndodhur;⁴
- Në kohën e shqyrtimit të ankesës, magjistrati nuk ushtronte funksionin e tij;⁵
- Shkelja i referohet fakteve që kanë ndodhur jashtë afatit 5 vjeçar të parashkrimit për hetimin disiplinor.

Shkaqet të cilat kanë çuar në arkivimin e një numri të madh ankesash janë objekt i analizave të vazhdueshme nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në funksion të hartimit të politikave të brendshme të punës, jo vetëm për të përmirësuar shërbimin në funksion të interesit publik dhe transparencës, por edhe zhvillimin e politikave ndërgjegjësuese në këtë drejtim.

3.3 Ankime kundër vendimeve të arkivimit

Bazuar në nenin 119, pika 4, dhe nenit 122, pika 5, e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankuesi ka të drejtën e ankimit në këshillin përkatës kundër vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës.

Në total vendimet e arkivimit kanë qenë 990.

Kundër vendimeve të arkivimit janë depozituar pranë këshillave, sa më poshtë:

- 80 ankime ndaj 785 vendimeve të arkivimit pas shqyrtimit fillestar;
- 4 ankime ndaj 205 vendimeve të arkivimit pas verifikimit;

Sikurse evidentohet më sipër rezulton një numër i ulët i ankimeve, në këshilla ndaj vendimeve të arkivimit. Nga 990 vendime arkivimi janë ankimuar vetëm 84, ose thënë në përqindje, janë ankimuar 8.4% e vendimeve të arkivimit.

- 84 ankime rezultojnë 0 vendime të rikthyera për shqyrtim nga Këshillat;

Nga 84 vendime arkivimi të ankimuar, rezulton se për të gjitha rastet këshillat kanë vendosur refuzimin si të pabazuar të ankimit të paraqitur nga ankuesit ndaj vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e për pasojë asnjë prej vendimeve të Inspektorit të Lartë të

⁴ Neni 120, pika 1, shkronja “d”, e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

⁵ Neni 120, pika 1, shkronja “ç”, e ligjit nr. 96/2016. Këto janë rastet kur magjistrati i ka mbaruar statusin, për shkaqet e përmendura në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016 apo kur magjistrati është shkarkuar nga KPA me vendim përfundimtar.

Drejtësisë, nuk është kthyer për rishqyrtim.

3.4 Hetimet Disiplinore

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në zbatim të neneve 123, pika 1 dhe 124, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer.

Referuar këtyre parashikimeve ligjore, gjatë vitit 2021 Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pasi konstatoi se ekzistonin dyshime të arsyeshme, ka miratuar 22 vendime për fillimin e hetimit disiplinor, me anë të të cilave janë hetuar shkeljet e pretenduara ndaj veprimtarisë së 28 magistratëve dhe 3 anëtarëve të këshillit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përfundim të hetimit disiplinor, analizës ligjore të fakteve të pranuar të cilat mbështetin përfundimin se shkelja disiplinore është kryer, për 17 magistratë ka paraqitur kërkesën për procedim disiplinor pranë këshillave. Ndërsa për 14 subjektet⁶ e tjerë të hetimit disiplinor rezultatet e hetimit janë sa vijon:

- Për 1 magistrat është pezulluar hetimi deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata;
- Për 4 magistratë është mbyllur hetimi disiplinor për shkak të:
 - të mbarimit të statusit të magistratit,
 - vlerësimit të fakteve, rrethanave të hetuara dhe provave të marra, si të pamjaftueshme për të provuar shkeljet e pretenduara;
- Për 9 subjekte të hetimit disiplinor, procedurat hetimore janë në faza të ndryshme sipas kërkesave të ligjit për zhvillimin e tyre.

Fillimi i hetimit disiplinor, për 31 subjekte të hetimit disiplinor ka filluar pas dyshimeve të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer nga subjekti. Shkeljet disiplinore për të cilat, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor, renditen në:

- shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit⁷;

⁶ Termi “subjekte”, i referohet magistratëve dhe anëtarëve të këshillit.

⁷ - neni 101/1/b, i ligjit nr. 96/2016, - shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit kur nuk i referohet ligjit ose fakteve, me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë, ose kur ka paaftësi të dukshme profesionale;
- neni 102/1/b/ii) i ligjit nr. 96/2016, - shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit kur paraqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, nëse ky veprim: ii) bëhet me qëllim që të krijohen përfitime të padrejta për palët dhe të tretët ose synon shmangien e detyrimit ligjor për shqyrtimin e çështjes apo të krijojë mundësinë që çështja të shqyrtohet nga një magistrat tjetër;
-neni 102/1/ç, i ligjit nr. 96/2016 - mos përmbyshja e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjyqimit ose hetimit;
-neni 102/1/d, i ligjit nr. 96/2016- vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale;

- shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit⁸;
- shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale me vendim të formës së prerë, që sipas natyrës së tyre, diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, bazuar në faktet dhe rrethanat e pranuar nga gjykata⁹.

Nga përfundimi i hetimit disiplinor gjatë vitit 2021, për 21 magjistratë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka propozuar fillimin e procedimit disiplinor për 17 magjistratë, ose për 81% të rasteve të hetuara, ndërsa për 4 magjistratë ka vendosur mbylljen e hetimit disiplinor.

3.5 Kërkesat për procedim disiplinor dhe vendimet e Këshillave

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 138 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas vlerësimit të provave të mbledhura dhe kur rezultatet e hetimit, çojnë drejt përfundimit se ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, fillon procedimin disiplinor pranë këshillave, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.

Gjatë vitit 2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor për 17 magjistratë, për 11 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të

- neni 102/1/dh, i ligjit nr. 96/2016 - veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin;

- neni 102/1/f, i ligjit nr. 96/2016 - Mungesa e pajustificuar në detyrë, sipas parashikimeve të këtij ligji, për më shumë se 3 ditë pune në vit;

-neni 102/1/g, i ligjit nr. 96/2016 - shkelja e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave ose prokurorisë;

-neni 102/1/gj, i ligjit nr. 96/2016 - moszbatimi pa shkaqe të justifikuara i vendimeve të dhëna nga këshilli ose refuzimi i zbatimit të masës disiplinore të dhënë ndaj magjistratit;

-neni 102/1/l, i ligjit nr. 96/2016 – mos përmbushja nga ana e kryetarit e detyrimeve të përcaktuara në ligj, në veçanti detyrat e lidhura me sistemin e menaxhimit të çështjeve;

-neni 102/1/nj, i ligjit nr. 96/2016 - mos njoftimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga ana e kryetarit, lidhur me fakte në dijeni të tyre, që mund të përbëjnë shkelje disiplinore të magjistratit;

-neni 102/2/a, i ligjit nr. 96/2016 - mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë;

- neni 102/2/b, i ligjit nr. 96/2016- shkelja e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave ose prokurorisë, në lidhje me funksionet e magjistratit në gjykim ose hetim/

- neni 102./2/c i ligjit nr. 96/2016- moszbatimi pa shkaqe të justifikuara i vendimeve të dhëna nga Këshilli ose refuzimi i zbatimit të masës disiplinore të dhënë ndaj magjistratit.

- neni 102/2/dh, i ligjit nr. 96/2016 - shkelja e përsëritur ose e rëndë e rregullave të solemnitetit, rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me palët, subjektet e tjera të përfshira në proces, me kryetarin, magjistratët e tjerë, si dhe me personelin e administratës gjyqësore.

- neni 103/1 pika a, ligji nr. 115/2016- mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga pjesëmarrja në mbledhjen plenare ose në mbledhjet e komisioneve, kur është e detyrueshme, sipas ligjit, nëse anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka dijeni ose duhet të kishte dijeni për rrethanat të tilla.

- neni 103/1 pika k, ligji nr. 115/2016- shkelja e rregullave të papajtueshmërisë ose të parandalimit të konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

⁸ Neni 103/1/dh, i ligjit nr. 96/2016, për shkelje jashtë ushtrimit të funksionit për raste të sjelljes që diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës dhe shkelje të kodit të etikës gjyqësore

⁹ Neni 104, i ligjit nr. 96/2016, për shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale,

Lartë Gjyqësor dhe për 6 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor, bazuar në shkeljet disiplinore¹⁰ të parashikuar nga nenet 102-104 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për:

Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit si:

- paraqitje e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, për qëllim të krijimit të përfitimeve të padrejta për palët dhe të tretët ose me synimin e shmangies së detyrimit ligjor për shqyrtimin e çështjes apo krijimit të mundësisë që çështja të shqyrtohet nga një magjistrat tjetër; - 1 magjistrat;
- mospërbushje e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit; - 4 magjistratë;
- vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale - 4 magjistratë;
- veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin - 3 magjistratë;
- mungesa e pajustificuar në detyrë, sipas parashikimeve të këtij ligji, për më shumë se 3 ditë pune në vit; - 1 magjistrat;
- shkelje e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave ose prokurorisë; - 1 magjistrat;
- moszbatimi pa shkaqe të justifikuara i vendimeve të dhëna nga këshilli ose refuzimi i zbatimit të masës disiplinore të dhënë ndaj magjistratit; - 1 magjistrat;
- mos përbushje nga ana e kryetarit e detyrimeve të përcaktuara në ligj, në veçanti detyrat e lidhura me sistemin e menaxhimit të çështjeve; - 1 magjistrat;
- mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë; - 5 magjistratë;
- shkelje e përsëritur ose e rëndë e rregullave të solemnitetit, rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me palët, subjektet e tjera të përfshira në proces, me kryetarin, magjistratët e tjerë, si dhe me personelin e administratës gjyqësore; - 2 magjistratë.

Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit për:

- sjellje që diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës, si dhe shkelje të Kodit të Etikës Gjyqësore; -1 magjistrat.

Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale - 4 magjistratë.

¹⁰ Për 5 magjistratë në kërkesat për procedim disiplinor ka pasur më shumë se një shkelje disiplinore të dyshuar.

Për 11 kërkesat për procedim disiplinor të paraqitura në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka propozuar këto masa disiplinore¹¹:

- “Shkarkim nga detyra” – 6 raste;
- “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit: - 5 raste.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratëve Këshilli i Lartë i Gjyqësor:

- nga 6 raste “Shkarkim nga detyra”, ka pranuar kërkesat për 2 magjistratë, ka përfunduar procedurën disiplinore për shkak të mbarimit të statusit për 2 raste dhe për 1 rast procedimi disiplinor është në proces, ndërsa për rastin tjetër procedimi disiplinor është pezulluar.
- nga 5 raste “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit”, ka pranuar 2 kërkesa duke vendosur për një masë të ndryshme disiplinore, në 3 raste ka vendosur pezullim e procedimit disiplinor.

Për 6 kërkesat për procedim disiplinor të paraqitura në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka propozuar këto masa disiplinore:

- Shkarkim nga detyra” - 3 raste;
- “Vërejtje publike” - 3 raste.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratëve Këshilli i Lartë i Prokurorisë:

- nga 3 raste “Shkarkim nga detyra”, ka pranuar 1 kërkesë, ndërsa 2 rastet e tjera procedimi disiplinor është në proces;
- nga 3 raste “Vërejtje publike”, ka pranuar 1 kërkesë, ndërsa për 2 raste procedimi disiplinor është në proces.

Procedimi disiplinor si momenti përmbyllës i veprimtarisë hetimore, i kushtohet vëmendje e posaçme sepse nuk ka si qëllim të vetëm ndëshkimin e magjistratëve, por edhe edukimin e tyre për rëndësinë që ka besimi i publikut në organet e reja të sistemit të drejtësisë. Në më pak se 2 vjet veprimtari, si rezultat i adresimit të shqetësimeve apo pretendimeve të qytetarëve, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar masa disiplinore nga vërejtje publike deri në shkarkim nga detyra..

Për 7 raste, hetimi ka çuar në procedim disiplinor si rezultat i shqyrtimit të ankesave të

¹¹ Rezultatet e vendimmarrjeve të këshillave janë vetëm për vitin 2021. Një pjesë e rasteve të deklaruar në proces janë përmbyllur gjatë vitit 2022, të dhënat e të cilave do të jenë pjesë e raportit të veprimtarisë për vitin 2022.

paraqitura nga ankuesit¹² në përputhje me nenin 123 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Konkretisht për 2 raste me ankesë të qytetarëve të paraqitura në ILD, dhe për 5 raste hetimi disiplinor është vazhduar në kuadër të procedurave hetimore të filluara nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Si rezultat i fillimit të hetimit disiplinor me iniciativë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në përputhje me nenin 124 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për 10 raste, është vijuar me procedimin disiplinor pranë këshillave përkatës, nga të cilat 5 raste janë denoncime publike në media, 3 raste hetimi disiplinor është vazhduar në kuadër të procedurave hetimore të filluara nga Ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, 1 rast procedimi disiplinor ka rezultuar nga inspektimi tematik me objekt “Lirimi me kusht”, dhe 1 rast nga informacioni i përcjellë nga zëvendëskryetari i gjykatës ku magjistrati ushtronte detyrën.

Në përfundim, prej 17 procedimeve, 7 prej tyre kanë ardhur si rezultat i shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga kategoria qytetar, të cilat zënë një volum prej 41% të rasteve të procedimit disiplinor.

3.6 Ecuria e trajtimit të ankesave të mbartura

Gjatë vitit 2021, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë ka qenë prioritet ulja e numri të ankesave (backlog) të trashëguara nga institucione të tjera për shkak të kompetencave të kufizuara e të ndara ndërmjet organeve të ndryshme gjatë periudhës kalimtare si Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor, apo Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Sikurse është paraqitur në raportin e veprimtarisë së vitit 2020, janë transferuar 2104 ankesa dhe praktika në faza të ndryshme trajtimi. Numri i konsiderueshëm i ankesa të transferuara, përfshin të gjitha ankesat, sipas statusit të tyre në momentin e transferimit, të cilat kanë qenë të pa trajtuara, të trajtuara pjesërisht apo në faza fillestare të shqyrtimit të tyre, si dhe raste të hetuara pjesërisht apo të papërfunduara nga ana e organeve të mëparshme.

Shqyrtimi i tyre pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka nisur duke bërë një kategorizim dhe evidentim të fazave procedurale ku ndodhen dhe vendosjen e përparësive për trajtim. Ankesat apo praktikat dokumentare, janë trajtuar sipas një radhe përparësie të bazuar në kriteret si: data e dorëzimit, faza e trajtimit nga ana e organeve të mëparshme, tipologjia ose urgjenca e trajtimit të ankesës, në respektim të parimit të barazisë dhe objektivitetit, si dhe kohës së nevojshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e secilës praktikë dokumentare. Në kuadër të këtyre masave gjatë vitit 2021, rezulton se nga fondi total prej 2104 ankesa, rezultojnë të jenë trajtuar 427 ose 20% e ankesave dhe mbeten për t'u trajtuar 1677 ankesa.

¹² Në këtë rubrikë, informacioni i paraqitur i referohet të gjitha rasteve që i përkasin kategorive të ankesave që vijnë me ankesë dhe të dhënat reflektojnë edhe numrin e ankesave të ardhura edhe nga institucionet publike, shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe media.

3.7 Të dhëna të përgjithshme mbi ankesat e regjistruara

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka analizuar të dhënat statistikore me synimin parësor paraqitjen e informacionit sasior dhe cilësor të përmbledhur që karakterizon dukuri të caktuara. Konkretisht, parë nga numri i lartë i ankesave që vijnë nga kategoria individ, janë identifikuar të dhëna që i përkasin subjektit dhe objektit të ankesave. Analizimi i këtyre të dhënave është parë me dobi në funksion të hartimit të politikave të brendshme të punës, jo vetëm për të përmirësuar shërbimin në funksion të interesit publik dhe transparencës, por edhe kuptimit më të mirë të individit që paraqet ankesë dhe zhvillimin e politikave ndërgjegjësuere në këtë drejtim.

Referuar të dhënave të grumbulluara për subjektet që vënë në lëvizje Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, nga 990 vendimet e arkivimit, është bërë kategorizimi i të dhënave, sipas kategorisë së subjekteve, të ndara në “person fizik” dhe “juridik”. Nga 990 vendime arkivimi, për 945 prej tyre, janë marrë pas shqyrtimit të ankesave të individëve, 41 vendime arkivimi janë marrë pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur, nga persona juridikë¹³, dhe 4 prej tyre janë marrë pas shqyrtimit të ankesave që vijnë nga media.

Një dukuri tjetër e analizuar ka qenë shpërndarja gjeografike e ankuesve¹⁴, prej së cilës rezulton se: Tirana është qarku me numrin më të lartë të ankuesve, me 375 vendime të marra nga ankues që kanë deklaruar vendbanimin në këtë qytet, i ndjekur nga ai i Vlorës me 70 vendime, Durrësit me 66 vendime, Fierit me 66 vendime, Lezhës me 57 vendime, Korçës me 57 vendime dhe ai i Shkodrës me 51 vendime.

Gjithashtu të dhënat tregojnë se për kategorinë e vendimeve të arkivimit, për 48 raste, ankesat kanë ardhur nga ankues të cilët kanë si vendbanim të regjistruar institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Për 18 prej ankuesve nuk është treguar adresa, 14 prej ankuesve janë me adresë të regjistruar jashtë kufijve të Shqipërisë dhe 6 prej tyre kanë përcjellë ankesat e tyre përmes postës elektronike, pa përcaktuar adresë.

Për ankesat e paraqitura nga individë, janë grumbulluar edhe dy tregues të tjerë, atë të gjinisë dhe grup-moshës së ankuesve. Konkretisht nga të dhënat e grumbulluara, rezulton se nga ankesat e shqyrtuara, 626 ankues i përkasin kategorisë “meshkuj” dhe 226 ankues i përkasin kategorisë “femra”. Ndërsa sa i takon grup-moshës, për ankesat e paraqitura nga individë, janë evidentuar të dhënat e paraqitura në formë tabelore, si më poshtë:

Tabela nr. 1 “Grup-mosha e ankuesit”.

¹³ Për këtë kategori, janë grupuar të dhënat për institucione publike, shoqëri tregtare, organizata jo fitimprurëse dhe media.

¹⁴ Për këtë kategori, janë grumbulluar të dhëna sipas qyteteve të deklaruara nga ankuesit në komunikimet e mbajtura me Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Grup-mosha	Numri i ankuesve
20-30 vjeç	19
30-40 vjeç	102
40-50 vjeç	186
50-60 vjeç	290
Mbi 60 vjeç	386

3.7.1 Shkelje të pretenduara nga ankuesi

Të dhëna e analizuar në kuadër të kësaj rubrike i përkasin të dhënave të nxjerra nga pretendimet e ankuesve në ankesat e depozituar për shkelje disiplinore të subjektit të hetimit disiplinor. Nisur nga të dhënat e administruara për periudhën njëvjeçare të raportimit, nga kjo rubrikë vëmë re se ankesat e paraqitura i referohen më së shumti pretendimeve që kanë individët në lidhje me “veprimtarinë e magjistratëve” gjatë ushtrimit të detyrës, kjo pasi të gjithë subjektet ankues kanë pasur çështjet për gjykim apo nën hetim nga gjykatat apo prokuroritë.

Të dhënat në lidhje me llojin e shkeljes së pretenduar nga subjektet ankues të cilët kanë depozituar ankesë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, konstatohen të dhënat sipas tabelës nr. 2, për shkeljet e pretenduara sipas ankesave të paraqitura, për gjyqtarë dhe prokurorë.

Tabela nr. 2 “Shkeljet e pretenduara sipas ankesave të paraqitura, për gjyqtarë dhe prokurorë”.

SHKELJE TË PRETENDUARA NGA ANKUESI	GJYQTAR	PROKUROR
Vendimmarrje të padrejta të magjistratëve gjatë shqyrtimit të një çështje	207	93
Vendimmarrje të magjistratëve të cilësuar si të njëanshme	61	22
Shkelje procedurale	113	47
Zvarritje të procesit gjyqësor	125	38
Moszbatim i ligjit material	25	2

Shkelje të etikës së magistratit	23	4
Mosrespektim formal të ligjit	25	0
Veprime/mosveprime në kundërshtim me ligjin	50	65
Totali	629	271

Ajo që vihet re është fakti se ankesat më të shumta i referohen shkeljeve me objekt vendimmarrje të padrejta të magistratëve gjatë shqyrtimit të një çështje, shkelje procedurale dhe zvarritje të procesit gjyqësor/hetimor. Sa i përket ndarjes së kategorisë midis magistratëve, rezulton se ankuesit ankohen më tepër për subjekte të procedimit disiplinor, të profilit gjyqtar. Ndërsa për kategorinë veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin, analiza e të dhënave ka nxjerrë në pah se magistratët e profilit prokuror, ata që kanë numrin më të lartë të rasteve.

Nxjerrja në pah e këtyre të dhënave është parë e rëndësishme, andaj edhe është evidentuar në këtë raport, si një tregues që lidhet ngushtësisht me kuptimin e misionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga publiku i gjerë. Kjo lidhet me një ndër përparësitë që ka Inspektori i Lartë, në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit të publikut mbi misionin e veprimtarisë së ILD-së. Të dhënat e përfuara i shërbejnë hartimit të politikave në këtë fushë me synim thjeshtimin dhe kuptimin e drejtë të misionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut, është premisë për krijimin e lehtësirave në minimizimin e fluksit të ankesave, të cilat janë jashtë objektit të veprimtarisë, apo janë të papranueshme për shkak të mos përmbushjes së kriterëve ligjore. Po kështu evidentimi i një të dhëne të tillë i shërben nevojave për përmirësim, qoftë në nivel dhënie shërbimi, por edhe të kuptimit nëse ndërgjegjësimi ka arritur të përmbushë qëllimin e tij, atë të thjeshtimit dhe edukimit të publikut në drejtim të kuptimit të drejtë të sjelljeve që i japin shkak procedimit disiplinor nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Sa i përket ankesave të trajtuara me vendim arkivimi ka rezultuar se ankuesit më shumë pretendime kanë ngritur ndaj magistratëve të këtyre gjykatave:

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (124 ankesa);
2. Gjykata e Apelit Tiranë (60 ankesa);
3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (45 ankesa);
4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër (42 ankesa);
5. Gjykata e Apelit Vlorë (38 ankesa);
6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier (35 ankesa);
7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë (28 ankesa);
8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (28 ankesa);

Ndërsa përsa sa i takon, ankesave të trajtuara me vendim arkivimi ka rezultuar se ankuesit

më shumë pretendime kanë ngritur ndaj këtyre prokurorive:

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (124 ankesa);
2. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë (60 ankesa);
3. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës (23 ankesa);
4. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier (21 ankesa)
5. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë (21 ankesa);
6. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë (14 ankesa);

3.7.2 Ankesat e trajtuara, sipas objektit të padisë.

Nga informacioni i gjeneruar, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është identifikuar lloji i procesit gjyqësor/objektit të padisë së shqyrtuar nga ana e magjistratit ndaj të cilit ngrihen pretendime. Nga ankesat e trajtuara pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë vitit 2021, rezultojnë të dhënat si më poshtë:

Lloji i çështjeve	Nr. Total
Çështje Penale	436
Çështje Civile	391
Çështje Administrative	26
Çështje të papërcaktuara	77

Lloji i Veprës Penale	Nr. Total
Vrasje	46
Falsifikim	48
Shpërdorim detyre	40
Mashtrim	25
Vjedhje	21
Vepra penale kundrejt të miturve	7
Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor	24
Vepra penale në familje	12
Të tjera.	213
Totali	436

Objekti i padisë civile	Nr. Total
Çështje të pronësisë	90
Shpërblim dëmi financiar	34
Zgjidhje martese	12
Të tjera	255
Totali	391

Objekti i Padisë Administrative	Nr. Total
Pavlefshmëri Akti	2
Detyrim shpërblimi/kompensimi monetar	2
Shfuqizim akti administrativ/anulim vendimi	6
Të tjera	16
Totali	26

3.8 Inspektimet tematike

Në mbështetje të nenit 194 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në objektin e veprimtarisë së tij, ndër të tjera kryen edhe inspektime institucionale dhe tematike në lidhje me çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë.

Pavarësisht sfidave të ngritjes, numrit të lartë të ankesave të mbartura dhe të ardhura, si dhe të numrit të pamjaftueshëm të inspektoreve, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, deri tani ka në proces 1 inspektim tematik, të nisur nga viti 2020 dhe ka filluar 2 inspektime tematike gjatë 2021, sipas këtyre akteve:

1. Vendim nr. 1 datë 11.02.2020, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave objekt “Lirim me Kusht”.
2. Vendim nr. 37, datë 01.06.2021 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm””, i ndryshuar.
3. Vendim nr. 47, datë 15.07.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: “Respektimi i kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal” për veprën penale “Të mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”.

Pas marrjes së të dhënave nga gjykatat dhe prokuroritë të përfshira në këtë inspektim tematik, dhe analizimit të tyre gjatë procedurave inspektuese të ndjekura, për inspektimin tematik për “lirim me kusht”, janë paraqitur 2 kërkesat për procedim disiplinor në vitin 2020 dhe 1 kërkesë për procedim disiplinor gjatë vitit 2021. Ndërsa për dy inspektimet e tjera të sipër përmendura, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është në proces të analizimit të të dhënave të administruar për secilin inspektim tematik, rezultatet e të cilëve priten të dalin gjatë vitit 2022.

Në secilin prej vendimeve për kryerjen e inspektimeve tematike, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar edhe metodologjinë e inspektimit që do të ndiqet. Analiza e të dhënave dhe rezultateve në këto tre raste do të shërbejnë si pikënisje për fillimin e punës për hartimin e një metodologjie të përgjithshme inspektimi. Krahas të dhënave që do të nxjerrin në pah inspektimet në proces, do të punohet edhe me asistencën dhe mbështetjen e homologëve dhe partnerëve ndërkombëtarë, në përgatitjen e një metodologjie të përgjithshme inspektimi, e cila do të shërbejë në ndjekjen dhe zbatimin e planit vjetor të inspektimeve.

Përveç inspektimeve të iniciuara, puna e deritanishme është e fokusuar në drejtim të organizimit të disa aktiviteteve të cilat kanë si synim ndërtimin e një metodologjie të caktuar

për realizimin e inspektimeve. Njëkohësisht në funksion të inspektimit, paraqitet si nevojë zhvillimi i projekteve teknologjike dhe sigurimi i investimeve në teknologji të reja, bashkë me rritjen e kapaciteteve për përdorimin e saj, në të dy kahet e inspektimit.

Në funksion të përmirësimit të inspektimit, janë realizuar disa trajnime/ëorkshop-e dhe janë kryer disa takime me ndërkombëtarët për të marrë eksperiencat dhe përvojat më të mira në fushën e inspektimeve.

Marrja e vendimit për pranimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me status vëzhguesi, pranë Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë, shënon një përpjekje të madhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në fuqizimin e veprimtarisë që lidhet me inspektimet. Vendosija e kontakteve me institucionet homologe, këmbimi i praktikave të mira të punës, ofrimi dhe marrja e trajnimeve të përbashkëta, shkëmbimi i programeve me grupe inspektorësh dhe krijimi e platformave elektronike të shkëmbimit të praktikave, janë përpjekje konkrete në zhvillimin e çështjeve që priten të zhvillohen me shumë interes nga ky proces.

IV. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR

4.1 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë-Këshilli i Lartë Gjyqësor/Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Bashkëpunimi dhe forcimi i marrëdhënieve institucionale me të tjerët e sidomos me institucione të sistemit të drejtësisë, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë ka qenë dhe do të mbetet një drejtim shumë i rëndësishëm, për vijim më tej të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Me këtë qasje, më datë 07.07.2021 Inspektori i Lartë i Drejtësisë u bë mikpritës i një takimi të përbashkët, iniciuar nga aktorët e përfshirë në procesin e hetimeve dhe procedimeve disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, konkretisht KLGJ, KLP dhe ILD.

Ishte pikërisht zhvillimi i procedimeve të para disiplinore të paraqitura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në të dy Këshillat, bazuar në legjislacionin e ri të reformës në drejtësi, ai që nxiti krerët e institucioneve të reja, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, kryetaren e KLGJ-së, dhe kryetarin e KLP-së, të aktivizojnë një platformë komunikimi e koordinimi për të identifikuar problematikat me interes të përbashkët, që hasen gjatë zbatimit të ligjit, dakordësimin dhe koordinimin mbi zbatimin e standardeve uniforme, përmes garantimit të një procesi të rregullt disiplinor e në respekt të pavarësisë së magjistratëve.

Nga ana tjetër, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në çdo rast ka trajtuar me prioritet maksimal dhënien e informacionit ndaj këtyre institucioneve, për magjistratët që aplikojnë për ngritje në detyrë, brenda sistemit të karrierës. Kjo në kuadër të vlerësimit për sistemin e karrierës së magjistratëve nga dy Këshillat, lidhur me ekzistencën ose jo të procedurave disiplinore të nisura ose ankesave të depozituara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Për të lehtësuar komunikimin me KLGJ dhe KLP janë caktuar personat e kontaktit për bashkërendimin e punës dhe shkëmbimin e informacionit të vazhdueshëm, si me dy Këshillat, ashtu edhe me KPK.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi të nisur tashmë ndërinstitutional, prej muajit nëntor 2021, Zyra e ILD-së administron informacion nga KPK, për çdo vendimmarrje ndaj magjistratëve prokurorë apo gjyqtarë, në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Ndërsa prej datës 03 shtator 2021, ILD administron nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë konkretisht:

- Listat me emrat e magjistratëve, të cilët ushtrojnë aktualisht detyrën.
- Listat e ish- magjistratëve, të cilët nuk janë më pjesë e sistemit të drejtësisë.

Ky komunikim mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshillave përkatës dhe KPK-së, do të

jetë i vazhdueshëm për shkak të nevojave të përditësimit të informacionit, lidhur me magjistratët, të cilët vazhdojnë të jenë në sistem ose jo. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është rritja e efikasitetit të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në trajtimin e ankesave ndaj magjistratëve që janë në detyrë.

4.2 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë - Prokurori i Përgjithshëm.

Në kuadër të bashkëpunimit mes institucioneve, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm nënshkruan memorandumin e bashkëpunimit ndërinstitucional “Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”. Në kuadër të parashikimeve të memorandumit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është drejtuar me kërkesë Prokurorit të Përgjithshëm, për të propozuar tematika apo çështje të cilat i nënshtrohen inspektimit tematik apo institucional ndaj zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorive.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Prokurori i Përgjithshëm ka propozuar 6 çështje të cilat mund të jenë objekt inspektimi. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas një vlerësimi të kujdesshëm të tematikave të evidentuara nga Prokurori i Përgjithshëm, por edhe në analizë të Raportit të Prokurorit të Përgjithshëm¹⁵, ku del në pah mungesa e kohezionit institucional, mungesa e masave administrative apo organizative, apo për shkak të parashikimeve legjislativë, paraprkisht vlerësohet se mjeti i duhur për adresimin e tyre është zhvillimi i një inspektimi tematik me objekt: “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm””, i ndryshuar.”.

Gjatë periudhës së përgatitjes së këtij raporti veprimtarie, inspektimi tematik është në proces dhe mbetet e pritshme përfundimi i tij brenda vitit 2022. Në varësi të rezultateve të inspektimit dhe përfundimeve që do të arrihen, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të jepen rekomandime të karakterit legjislativ, administrativ, organizativ apo funksional lidhur me rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

Në të njëjtën kohë, zhvillimi i këtij inspektimi tematik do të shërbejë si një mjet për identifikimin e veprimeve/mosveprimeve apo sjellje të magjistratëve, të cilat në bazë të një dyshimi të arsyeshëm justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor sipas procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

¹⁵ Raportit të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2020”, i aksesueshëm në linkun: https://www.pp.gov.al/rc/doc/Raport_i_Vjetor_2020_Kuvendit_Kriminaliteti_PP_5290.pdf

4.3 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Ministrinë e Drejtësisë.

Që në nisje të punës së tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, u angazhua në ofrimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimtarive me pikëprerje të përbashkëta ndërmjet organeve të pushtetit ekzekutiv, që koordinojnë informacionet e organeve të pavarura kushtetuese, të sistemit të drejtësisë. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është përcjellja e informacioneve mbi veprimtarinë, në kuadër të përmbushjes së politikave shtetërore në fushën e drejtësisë dhe atyre të procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Bashkëpunimi është konkretizuar në ofrimin e kontributeve, hartimin e raporteve dhe përcjelljen e informacioneve në ushtrim të kompetencave, sipas çështjeve të përcaktuara në Planin e Masave, mbi zbatimin dhe monitorimin e përmbushjes së rekomandimeve të Komisionit Evropian, lidhur me Kriterin Politik dhe Kapitullin 23, të *Aquis* së Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, pas përfundimit të fazës së parë të reformës në drejtësi, mes zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2016-2020 dhe vijimit të konsolidimit të mëtejshëm të kësaj reforme, mes proceseve për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale 2021-2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka përcjellë kontribute dhe ka marrë pjesë në takimet e mbajtura për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale 2021-2025. Pas miratimit të Strategjisë Ndërsektoriale do të vijohet me përcjelljen e kontributeve për objektivat strategjike, në cilësinë e organit përgjegjës, për disa aktivitete në përmbushjen e realizimit të strategjisë, sipas kërkesave të Ministrisë së Drejtësisë.

Gjatë vitit 2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka përcjellë kontribut edhe në instrumente ndërkombëtare, sipas çështjeve të përcaktuara në treguesit përkatës, që duhet të përmbushen nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si për shembull Kontrata Sektoriale “BE për Reformën në Drejtësi”, miratuar me vendimin nr. 476, datë 10.07.2019, të Këshillit të Ministrave mbi “Miratimin në parim të Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2018, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA II)”¹⁶.

Bashkëpunimi mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë gjatë vitit 2021, në kuadër të politikave shtetërore për sistemin e drejtësisë, është zhvilluar nëpërmjet një sërë raportimesh apo aktiviteteve të mbajtura në kuadër të këtyre raportimeve, konkretisht:

¹⁶ <https://kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-10-korrik-2019/>

1. Raportim periodik në kuadër të përmbushjes së treguesve të pasaportës së indikatorëve dhe Planit të Veprimit për Strategjinë Ndërsektoriale 2021-2025;
2. Raportim periodik për përmbushjen e indikatorëve në zbatim të Kontratës Sektoriale “BE për Reformën në Drejtësi” ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian.
3. Raportim periodik për zbatimin e rekomandimeve të Progres Raportit Vjetor të Komisionit Evropian për Shqipërinë.
4. Raportim periodik për zbatimin e rekomandimeve të Nënkomitetit “Drejtësia, Liria dhe Siguria”.
5. Raportim periodik për zbatimin e rekomandimeve për Kapitullin 23, të Progres Raportit “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore dhe Kriterin Politik”.
6. Raportim në zbatim të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian për periudhën 2022-2024.
7. Përmbledhje Vjetore Ekzekutive, për reformën në drejtësi për vitin 2020.

4.4 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka ofruar bashkëpunim mbi bazë kërkesë, në kuadër të përmbushjes së politikave shtetërore në fushën e politikës së jashtme dhe atyre të procesit të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian si dhe ka kontribuar në përcjelljen e informacioneve drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Bashkëpunimi me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme ka pasur në fokus monitorimin e zbatimit të parashikimeve të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për Shqipërinë, në funksion të aktiviteteve dhe takimeve periodike të përbashkëta sipas Nënkomitetit: Bashkimi Evropian-Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria”.

Angazhimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këtë Nënkomitet ka qenë përmes paraqitjes së raportimeve periodike, si dhe nëpërmjet takimeve të grupit ndërinstitucional të punës. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ofruar bashkëpunim të plotë në kuadër të përmbushjes së politikave shtetërore në fushën e politikës së jashtme dhe atyre të procesit të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian,

4.5 Bashkëpunimi me aktorët e shoqërisë civile.

Duke qenë se ngritja e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, ka kaluar në një etapë të re zhvillimi, atë të paraqitjes së rezultateve të matshme e cilësore, për të justifikuar tashmë besimin e publikut tek drejtësia, informacioni i paraqitur në këtë rubrikë, vjen si një element i shtuar, në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit të opinionit publik, mbi procesin e ofrimit dhe bërjes publik të informacionit mbi veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por edhe si një vlerë e shtuar, në drejtim të rritjes dhe forcimit të besimit të publikut ndaj ushtrimit të veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në kuadër të projektit “All Eyes on Justice-Monitoring the Justice Reform in Albania”, mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shqipëri, përmes programit MATRA, nga ana e Institutit për Studime Publike e Ligjore (ISPL), është kërkuar bashkëpunim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, për monitorimin e progresit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për vitin 2021-2022, në kuadër të arritjeve e rezultateve të parashikuara nga Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë, planin e saj të veprimit dhe pasaportës së indikatorëve (SND II), miratuar me vendimin nr. 823, datë 24.12.2021, të Këshillit të Ministrave.

Krahas monitorimit në kuadër të aktiviteteve të SND II, në fokus të monitorimit janë edhe një numër indikatorësh të parashikuar në Planin Strategjik dhe planin e veprimit të ILD-së, 2020-2022, por edhe të atyre që do të propozohen nga projekti, të cilat, së bashku, do të plotësojnë panoramën e arritjeve të ILD-së në kuadër të zbatimit të këtyre dokumenteve strategjike.

Me marrjen e kërkesës, në dhjetor 2021, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është vlerësuar ofrimi i bashkëpunimit në drejtim të paraqitjes së të dhënave të kërkuara, sipas programit që pritet të komunikohet nga ISPL.

Gjatë vitit 2021 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka qenë i hapur për monitorim dhe me ofrim informacioni për Komitetin Shqiptar i Helsinkit për dy nga projektet e financuara nga partnerë ndërkombëtarë, e të zbatuara nga KSHH, konkretisht “Ecuria e reformës në sistemin e drejtësisë” dhe “Drejt një efience dhe integritetit më të mirë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, të finalizuara me tryeza publike diskutimi me aktorë vendas e partnerë ndërkombëtarë.

Me Institutin për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI) “Qeverisja e mirë dhe institucionet e reja të drejtësisë në Shqipëri” Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ofruar transparencë në informacionin mbi veprimtari konkrete të institucionit si dhe ka marrë pjesë në aktivitetin “Qeverisja e mirë dhe qëndrueshmëria e institucioneve të drejtësisë në Ballkanin Perëndimor”, organizuar në Bruksel nga Qendra për Studime të Politikave Evropiane me qendër në Bruksel (CEPS) dhe Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI). Në kuadër të këtij eventi Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi një takim pune me COËEB, ku pati një shkëmbim të frytshëm dhe intensiv të pikëpamjeve mbi qeverisjen e mirë dhe qëndrueshmërinë e institucioneve të reja të drejtësisë.

4.6 Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë.

Një ndër prioritet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2021, ka qenë rritja e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, si në drejtim të rritjes e fuqizimit të kapaciteteve të zyrës së ILD-së, ashtu edhe në shkëmbimin e praktikave më të mira të punës. Në këtë drejtim gjatë vitit 2021, janë disa bashkëpunime të rëndësishme të arritura:

- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me projektin Euralius V “Konsolidimi i sistemit të drejtësisë në Shqipëri”, i cili përmes komponentëve të programit dhe aktiviteteve ka

mbështetur një sërë institucionesh ekzistuese dhe të reja të sistemit të drejtësisë, të krijuara nga reforma në drejtësi, ku ndër të tjera, edhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, ku përmes bashkëpunimit me këtë projekt, është përfituar:

- Ekspertizë në procese të konsultimit dhe hartimit të disa akteve të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë kushtuese e ligjore ndër të tjera, në dhënien e mendimit në hartimin disa akteve kryesore, si më poshtë:
 - Rregullat e vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve;
 - Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
 - Manualin për hetimin disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë;
 - Ndryshimet ligjore të propozuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.
- Zhvillim të trajnimeve në funksion të rritjes së kapaciteteve të trupës së inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve, si dhe trajnime me tema të posaçme mbi sistemin disiplinor në Shqipëri, ku u trajtuan në disa cikle trajnimesh, duke trajtuar aspekte të përgjithshme të sistemit disiplinor; çështje të kuadrit të ri ligjor mbi përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve e prokurorëve dhe përputhshmërinë e sistemit të ri disiplinor me standardet ndërkombëtare; specifikat e punës përgatitore përpara fillimit të një hetimi disiplinor, interpretime të ligjit, sjellja e magjistratit, si dhe zbatimi i dispozitave kushtuese gjatë periudhës tranzitore për shkak të vakumit¹⁷, të zhvilluara gjatë vitit 2021.
- Zhvillimin e sistemit elektronik të brendshëm për menaxhimin e ankesave, i cili është duke u përdorur nga njësia e inspektorëve, ndihmës inspektorëve dhe arkiv protokollit. Sistemi është pajisur me licenca të nevojshme për përdorimin e sistemit me afat vlefshmërie deri në gusht të vitit 2022. Gjatë muajit dhjetor të vitit 2021, nga ana e projektit Euralius V, është bërë dorëzimi i sistemit elektronik me nënshkrimin e marrëveshjes së transferimit të asetëve mes drejtueses së misionit dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sistemi i brendshëm i ankesave është pjesë e inventarit të asetëve të Zyrës së ILD-së, për të cilin do të merren masa për të bërë kërkesa buxhetore pranë MFE-së me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të sistemit dhe rinovimin e licencave përkatëse, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e sistemit dhe përmbushja e qëllimeve të tij. Duke marrë parasysh se sistemi, është vendosur në përdorim në kushtet siç është dorëzuar, ka filluar puna për vlerësimin e dokumentacionit teknik për të evidentuar qartësisht informacionin e nevojshëm, në funksion të hartimit të rregullave të brendshme për përdorimin e tij.
- Bashkëpunimi me misionin OPDAT, ka konsistuar në zhvillimin e trajnimeve me ekspertë amerikanë mbi etikën e magjistratëve.

¹⁷ Për informacion të detajuar të temave dhe periudhave të trajnimit informacioni i zgjeruar jepet në ndarjen 4 “Organizim i brendshëm”, të raportit.

- Bashkëpunimi me projektin CEPEJ (Komisioni Evropian për Eficiencën në Drejtësi në Këshillin e Evropës) të Këshillit të Evropës, përmes programit SEJ III “Forcimi i eficientës dhe cilësisë së sistemit të drejtësisë në Shqipëri”, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian. Bashkëpunimi synon forcimin e kapaciteteve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në disa aspekte të veprimtarisë, që nga inspektimi deri tek marrëdhënia me publikun.
 - Me angazhimin e CEPEJ, në qershor 2021 Inspektori i Lartë i Drejtësisë nisi bashkëpunimin me Inspektoratin e Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës, që drejton Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ).
 - Aktiviteti i radhës në kuadër të bashkëpunimit me CEPEJ ishte organizimi në Tiranë, me ftesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në nëntor të vitit 2021, i një vizite 3 ditore të nivelit të lartë të homologëve nga Inspektoratet e Drejtësisë së Rumanisë, Portugalisë e Francës, anëtarë të Rrjetit Evropian të Inspektimit. Paralelisht u zhvillua edhe një trajnim dy ditor me Njësinë e Inspektorëve, Ndhmësinpektorëve dhe Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi teknikat e inspektimit disiplinor nga ekspertë Inspektorë magjistratë të Inspektimeve të Francës, Italisë e Rumanisë.
 - Homologët e ILD nga Inspektoratet e Drejtësisë së Rumanisë, Portugalisë e Francës gjatë vizitës në Tiranë zhvilluan takime njohëse mbi sistemin shqiptar të drejtësisë në disa institucione, në Kuvendin e Shqipërisë, në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkollën e Magjistraturës dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
 - Në diskutimet e kryera është rënë dakord për rritjen e bashkëpunimit duke forcuar marrëdhëniet ndërinstitucionale dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në lidhje me procedurat e verifikimit të ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore, fillimin e procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe për inspektimet institucionale dhe tematike.

Frytet e kësaj vizite të nivelit të lartë në Tiranë u konkretizuan në drejtim të:

- Zhvillimit të negociatave për finalizimin e një memorandumi bashkëpunimi me strukturat homologe në Republikën e Italisë.
- Zhvillimit të negociatave për arritjen e një memorandumi bashkëpunimi me Inspektoratin e Drejtësisë së Rumanisë, me synim:
 - shkëmbimin e praktikave dhe përvojave në lidhje me hetimin disiplinor të magjistratëve, si dhe me inspektimet institucionale dhe tematike;
 - shkëmbimin e informacionit mbi sistemin ligjor dhe legjisllacionin në fushën e procedimeve disiplinore ndaj magjistratëve, si dhe aktivitetet legjisllative që lidhen me zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, masat e zbatimit të ligjit në fushat e juridiksionit të tyre dhe përvojën e tyre ndërkombëtare;

- dhënien e këshillave mbi praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare të zbatueshme gjatë hetimeve disiplinore, duke përfshirë jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
 - shkëmbimin e përvojave mbi metodologjinë e kryerjes së inspektimeve tematike dhe institucionale dhe standardizimin e procedurave të inspektimit;
 - zhvillimin ndërmjet dy inspektorateve, të praktikave reciproke të punës, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe marrjen e praktikave më të mira;
 - shkëmbimin e përvojës në mjetet e komunikimit me publikun për të garantuar parimin e transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale dhe integritetit të magjistratëve;
 - forcimin e njohurive, përvojës dhe kapaciteteve të palëve nëpërmjet organizimit të vizitave studimore dhe atyre të punës, takimeve për çështje me interes të përbashkët, aktiviteteve të përbashkëta trajnuese.
- Nënshkrimi të Memorandumit të Mirëkuptimit, ndërmjet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektoratit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Bullgarisë, për fuqizimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale dhe shkëmbimit të praktikave më të mira, në kuadër të procedurave të verifikimit të ankesave, hetimit të shkeljeve disiplinore, fillimit të procedurës disiplinore ndaj magjistratëve si dhe të realizimit të inspektimeve institucionale e tematike, bashkëpunimi ka në fokus fushat me interes të ndërsjellë, i cili do të realizohet përmes:
 - Shkëmbimit të praktikave dhe përvojave që lidhen me hetimin disiplinor të magjistratëve, si dhe inspektimet institucionale dhe tematike;
 - Shkëmbimit të informacioneve për sistemin ligjor dhe legjislacionin në fushën e procedurave disiplinore ndaj magjistratëve, si dhe aktivitetet legjislative të rëndësishme për zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, masat e zbatimit të ligjit në fushat e juridiksionit të tyre dhe eksperiencën e tyre ndërkombëtare;
 - Ofrimin e këshillimit mbi praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare të zbatueshme gjatë procedurës së hetimit disiplinor, përfshirë jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
 - Shkëmbimit të përvojave mbi metodologjinë e kryerjes së inspektimeve tematike dhe institucionale dhe standardizimit të procedurave inspektuese;
 - Shkëmbimit të përvojave mbi mënyrën e komunikimit me publikun me qëllim garantimin e parimit të transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale e integritetit të magjistratëve;
 - Fuqizimit të njohurive, eksperiencës dhe kapaciteteve të pjesëmarrësve, nëpërmjet organizimit të vizitave studimore dhe atyre të punës, takimeve në çështjet e interesit të përbashkët ose veprimtarive të përbashkëta trajnuese.
 - Marrjen e vendimit unanim, më datë 10 dhjetor 2021, për pranimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me statusin e vëzhguesit, në Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë, çka shënohet një arritje e veçantë, pasi anëtarësia është vetëm për vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Bashkëpunimi i

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë ka për qëllim ndarjen e praktikave të punës nga shërbimet e inspektimit në vendet Evropiane, trajnime të përbashkëta, shkëmbimin e programeve me grupe inspektorësh dhe krijimin e platformave elektronike të shkëmbimit të praktikave.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi në dhjetor 2021, është zhvilluar një aktivitet me pjesëmarrjen e të gjithë punonjësve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me synim njohjen e praktikave Evropiane dhe parimeve të përgjithshme rreth inspektimeve institucionale dhe tematike.

- Edhe gjatë vitit 2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka patur takime sistematike pune me ambasadorë të huaj, vendet e të cilëve kanë në fokus mbarëvajtjen e reformës në drejtësi dhe kanë shprehur interes për ecurinë e punës apo kanë ofruar mbështetje. Kështu gjatë takimit me kreun e prezencës së OSBE në Shqipëri, Ambasadorin Vincenzo del Monaco, u shpreh vullneti për të vijuar bashkëpunimin ndërinstitucional si dhe gatishmëria për të mbështetur Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në ushtrimin sa më efikas të funksioneve kushtetuese dhe mbështetjes së veprimtarisë, përmes fuqizimit të kapaciteteve. Në kuadër të këtij takimi është diskutuar për mbështetje konkrete përmes asistencës për hartimin e planit strategjik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe për komunikimin me publikun
- Gjatë vitit 2021 është vendosur një marrëdhënie bashkëpunimi me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (Albanian-American Development Foundation - AADF). Për këtë qëllim është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe AADF-së, ku është rënë dakord për angazhim të përbashkët për një marrëdhënie bashkërenduese dhe bashkëpunuese me qëllim zbatimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të Programit të Liderimit në Shqipëri “LEAD Albania”, sipas modelit të Programit të Shtëpisë së Bardhë për Liderimin (White House Fellows Program) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky program u siguron profesionistëve të rinj dhe të talentuar shqiptarë përvoja të drejtpërdrejta në procesin e qeverisjes së Shqipërisë. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, prej muajit shtator të vitit 2021, përmes procedurave të brendshme të programit është përzgjedhur kandidati i LEAD Albania, i cili mban pozicionin e Këshilltarit pranë Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

4.7 Zbatimi i rekomandimeve të instrumenteve ndërkombëtare, në kuadër të procesit për integrimin evropian.

Më 19 tetor 2021, Komisioni Evropian miratoi dhe publikoi Raportin e Progresit për Shqipërinë për vitin 2021, duke paraqitur një vlerësim të detajuar vjetor të progresit e reformave të kryera gjatë vitit të kaluar, si dhe rekomandimet e udhëzimet për prioritetet e reformave. Në këtë raport, Komisioni ka bërë vlerësimin e punës edhe për institucionet e reja të drejtësisë, duke analizuar edhe punën e institucionit më të ri të dalë nga reforma në drejtësi,

Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, për të cilin vlerëson se ka përmbushur plotësisht funksionet e tij gjatë periudhës raportuese.

Konkretisht, sipas progres raportit Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kryer plotësisht funksionet e tij gjatë periudhës raportuese, veçanërisht duke filluar dhe kryer hetime disiplinore ndaj magistratëve. Krahas vlerësimit të punës, Komisioni ka theksuar nevojën për përmbushjen e këtyre rekomandimeve:

- Emërimin e inspektorëve jomagjistratë;
- Marrja e masave për trajtimin e ankesave të mbartura¹⁸, dhe
- Mundësia e kryerjes së inspektimeve tematike të rregullta.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve të sipërpërmendura, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, gjatë vitit 2021, në funksion të emërimeve të inspektorëve të tjerë, ka vijuar me shpalljen publike të procedurës së përzgjedhjes, në faqen zyrtare elektronike të institucionit, në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, si dhe në standat e informimit për publikun. Pas përfundimit të afatit 1 (një) muaj për shprehje interesi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me urdhrin nr. 142, datë 29.10.2021 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, i cili në datën 08.11.2021, ka filluar procedurën përzgjedhëse për 19 kandidatë, të cilët kanë shprehur interes për pozicionin e inspektorit jomagjistrat, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në vijim të procedurës përzgjedhëse në përputhje me vendimin nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, pas përmbushjes së detyrimit për pajisjen e kandidatëve me formularët përkatës dhe dorëzimin e tyre pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është vijuar me dërgimin e shkresave zyrtare pranë institucioneve përkatëse, me qëllim marrjen e informacionit, mbi të cilin do të bazohet verifikimi i plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimi i figurës e i pasurisë.

Në përfundim të procesit të mbledhjes së informacionit nga institucionet përkatëse, do të vijohet me fazat e mëtejshme të procedurës përzgjedhëse për kandidatët, që kanë shprehur interes për pozicionin inspektor jomagjistrat, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Krahas procedurës së shpalljes për emërimet në ILD, janë vlerësuar si të nevojshme edhe ndërhyrjet ligjore, ku ndër të tjera, lidhur me plotësimin e këtij rekomandimi është propozuar ndryshimi për rishikimin e raportit të numrit të barabartë të inspektorëve, në mënyrë që

¹⁸ Ankesa të mbartura janë të gjitha ankesat që kanë qenë në faza të ndryshme trajtimi apo të depozituara rishtazi, në organet kompetente për periudhën kalimtare deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas parashikimeve të bëra në Pjesën VI të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

përmes procedurave konkurruese të plotësohej numri i inspektorëve jomagjistratë. Ndryshimet e propozuara nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk u morën parasysh nga Ministria e Drejtësisë dhe deri në përfundim të periudhës së raportimit, nuk ka një përgjigje nga kjo Ministri ndaj propozimit të ILD-së për ndryshime ligjore.

Sa i përket përmbushjes së rekomandimit për trajtimin e ankesave të mbartura, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka trashëguar një sasi të konsiderueshme prej 2104 ankesash, në lidhje me trajtimin e të cilave Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar 3 urdhra të përgjithshëm. Me urdhrin e parë është bërë evidentimi dhe kategorizimi i tyre sipas fazave në të cilat ndodheshin; urdhri i dytë vendosi radhën e përparësisë së tyre, duke dhënë mundësinë e trajtimit të atyre praktikave që ishin brenda afatit ligjor të hetimit dhe verifikimit të tyre; ndërsa urdhri i tretë, kishte për qëllim shpërndarjen për trajtim të ankesave të seleksionuara dhe kategorizuara, inspektorëve magjistratë, të komanduar në funksionin e inspektorit magjistrat nga ana e KLP-së.

Së fundmi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar urdhrin nr. 131, datë 21.09.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore, lidhur me ankesat e trajtuara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën janar-gusht 2021”. Duke qenë se ky proces u finalizua në kohë nga grupi i punës, u shty afati me qëllim evidentimin e të dhënave edhe për periudhën e mbetur, atë shtator-dhjetor 2021.

Në zbatim të këtij urdhri, grupi i punës ka nisur nga puna dhe ka krijuar bazën e të dhënave për ankesat e depozituara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe të praktikave të transferuara nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dhe të administruara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me qëllim pasqyrimin e të dhënave të sakta, sa i takon evidentimit të të dhënave statistikore lidhur me ecurinë e trajtimit të ankesave, pjesë e ankesave të mbartura.

Në funksion të plotësimit të rekomandimit të tretë, për kryerjen e inspektimeve tematike, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në respektim të kompetencave kushtetuese e ligjore, vlerëson inspektimin si një veprimtari të domosdoshme për verifikimin e respektimit të Kushtetutës, ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore si edhe kontribuimin në parandalimin e shkeljeve të ligjit dhe respektimit të standardeve e parimeve të administrimit të drejtësisë nga subjekti i inspektimit.

Nisur nga numri i pamjaftueshëm i inspektorëve aktualisht në detyrë, numrit të lartë të ankesave të mbartura, kapaciteteve të kufizuara në teknologji, mjedise pune dhe buxhet, për vitin 2021, janë nisur 2 (dy) inspektime tematike të cilat janë në proces¹⁹ dhe pritet që përfundimet e tyre të mbyllen brenda vitit 2022.

Ndërsa për inspektimin e nisur gjatë vitit 2020 dhe të vijuar edhe gjatë vitit 2021, për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave objekt “Lirimin me Kusht”, janë arritur rezultate konkrete duke paraqitur 3

¹⁹ Të dhënat mbi inspektimet tematike, gjenden në rubrikën “3.8 Inspektimet tematike”, të këtij raporti.

kërkesa për procedim disiplinor, nga të cilat 2 në vitin 2020 dhe 1 kërkesë për procedim disiplinor gjatë vitit 2021.

Në secilin prej vendimeve të inspektimit është miratuar edhe metodologjia që do të ndiqet, hartimi i kërkesave për informacion dhe aktet e nevojshme për zhvillimin e verifikimeve; përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur, afatet përkatëse dhe ecuria e ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve dhe rezultateve të inspektimit. Analiza e të dhënave dhe rezultateve në këto tre raste do të shërbejnë si pikënisje për fillimin e punës për hartimin e metodologjisë së inspektimit dhe planifikimit të inspektimeve.

Në mënyrë për të arritur konkretizimin e një planifikimi për kryerjen e një inspektimi, jemi në proces vlerësimi të ndërmarrjes së disa masave në funksion të përcaktimit të një planifikimi objektiv dhe të realizueshëm, ku konkretisht përmendim:

- Evidentim të dispozitave ligjore përkatëse në ligjet organike të sistemit të drejtësisë që parashikojnë detyrimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në ndërmarrjen e një inspektimi dhe funksionet ex-officio;
- Grumbullim të dhënave nga praktika e krijuar, për evidentimin e fenomeneve të shpeshta të sjelljeve të denoncuar apo pretendimet për shkelje të ndryshme nga ana e magistratëve apo administratës së gjykatave apo prokurorive;
- Vlerësim të mundësisë së hartimit të një metodologjie të përgjithshme që duhet të ndiqet gjatë përcaktimit të tematikave apo çështjeve të cilat duhet të përfshihen në planifikim;
- Paraqitjen e kërkesave organeve qeverisëse të sistemit, në çështjet apo tematikat për të cilat shihet e nevojshme kryerja e inspektimeve;
- Ndërmarrja e aktiviteteve trajnuese për rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve, për tema të lidhura me inspektimet;
- Rritjen e bashkëpunimit me aktorë të sistemit të drejtësisë, por dhe me struktura homologe evropiane, në funksion të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira evropiane në fushën e inspektimeve;
- Nxitjen e procesit të rekrutimeve dhe përthithjen e magistratëve në pozicionet e Inspektorëve.

V. ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Bazuar në parashikimet e nenit 197, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, e cila parashikon se: organizimi, struktura dhe numri i punonjësve të Zyrës së Inspektorit përcaktohen nga Kuvendi, me propozim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar me vendimin nr. 65/2020 strukturën organizative, organikën dhe klasifikimin e pagave të personelit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Referuar këtij vendimi numri total i personelit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është përcaktuar të jetë 93 punonjës.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është konceptuar si institucion kushtetues i pavarur, që organizohet dhe funksionon si entitet juridik, me buxhet të veçantë të financuar nga buxheti i shtetit si dhe burime të tjera financiare të parashikuara nga ligji, me strukturë dhe personel profesional dhe administrativ të nevojshëm për përmbushjen e kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore. Në përmbushje të veprimtarisë kushtetuese e ligjore Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka këtë organizim strukturor:

- *Kabineti i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*, veprimtaria e të cilit përveç detyrave të përcaktuara në rregullore, shërben në konsultimin dhe ndjekjen e çështjeve dhe detyrave të veçanta, të ngarkuara rast pas rasti nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.
- *Njësia e Inspektorëve*, veprimtaria e së cilës rregullohet në përputhje me parashikimet e Kushtetutës dhe legjisllacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë dhe legjisllacionit në fuqi për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.
- *Njësia e Ndihmës Inspektorëve*, të cilët mbështesin Njësinë e Inspektorëve në fazën para hetimit dhe pas hetimit disiplinor.
- *Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve dhe Shërbimeve Juridike* ka rol kryesor në përgatitjen e kuadrit rregullues të veprimtarisë së Inspektorit, analizës së përgjithshme, raportimeve dhe dhënien e mendimeve institucionale. Gjithashtu, drejtoria ofron edhe asistencën ligjore për publikun, që kërkon të ankohet pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- *Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse*, që ka funksione mbështetëse si financa, burimet njerëzore, prokurimet, protokoli dhe shërbime të tjera administrative.
- *Auditi i Brendshëm*, i cili monitoron performancën financiare, administrative dhe atë të inspektimeve. Në veçanti asiston Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për mbikëqyrjen e metodologjisë së inspektimeve dhe për shpërndarjen e punës, duke mbajtur parasysh ngarkesën, përvojën, kualifikimet dhe pengesat e mundshme ligjore.

Nga analiza e veprimtarisë dyvjeçare, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është parë e nevojshme që të paraqiten ndryshime në strukturën organizative, për një shpërndarje dhe

organizim më efektiv të disa njësive organizative, të cilat do të paraqiten në kohën e duhur pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

5.1 Komandime nga KLGJ

Për plotësimin e strukturës organizative dhe veçanërisht njësisë inspektuese, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë marrë një sërë masash, të cilat kanë pasur si qëllim realizimin e komandimeve për magjistratë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë deri në shkurt 2021, ka vijuar punën me një inspektor të vetëm nga 26 inspektorë të parashikuar në strukturë, si dhe ka kërkuar në mënyrë të përsëritur komandimin e magjistratëve të tjerë nga këshillat. KLGJ në total ka realizuar 7 njoftime, për komandimin e magjistratëve gjyqtarë në pozicionin e inspektorit magjistrat pranë Zyrës së ILD-së, të cilat nuk kanë rezultuar të suksesshme në drejtim të plotësimit të nevojave të ILD-së. Inspektori i Lartë i Drejtësisë në shtator të vitit 2021, i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke kërkuar, rishpalljen e procedurave për kandidimin e 6 (gjashtë) magjistratëve gjyqtarë për pozicionin inspektorë magjistratë pranë ILD-së.

Pas konsultimit me informacionin e publikuar në faqen zyrtare të KLGJ-së, rezulton se me vendimin nr. 572, datë 07.12.2021, të KLGJ-së, “Për rihapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, është vendosur:

- Rihapja e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- Shpallja e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për dy pozicione të lira si inspektorë.

Me njoftimin e datës 07.12.2021²⁰, së KLGJ-së janë ftuar magjistratë, që plotësojnë kushtet dhe kriteret e komandimit, për të paraqitur kërkesë për komandim, bashkë me afatet dhe procedurat që do të ndiqen në vijimësi. Ndërsa me njoftimin e datës 28.12.2021²¹ të KLGJ-së, pas përfundimit të afatit për ftesën për komandim, nuk u paraqit asnjë kandidaturë.

Gjatë vitit 2021 nuk ka pasur asnjë komandim në institucion. Nga ana tjetër, një inspektor magjistrat i komanduar, i cili po vijon punën pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka paraqitur kërkesën për ngritje në detyrë, kërkesë e cila pritet të shqyrtohet nga KLGJ-ja.

²⁰ Për më tepër, informacioni gjendet i njoftuar dhe i aksesueshëm, në linkun vijues:

<http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/Njoftim-i-dat%C3%ABs-07.12.2021-P%C3%ABr-rihapjen-e-procedur%C3%ABs-s%C3%AB-komandimit-n%C3%AB-ILD.pdf>

²¹ Për më tepër, informacioni gjendet i njoftuar dhe i aksesueshëm, në linkun vijues:

<http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/Njoftim-i-dat%C3%ABs-28.12.2021-Mbi-kandidimet-n%C3%AB-procedur%C3%ABn-e-komandimit-t%C3%AB-gjyqtar%C3%ABve-n%C3%AB-Zyr%C3%ABn-e-Inspektorit-t%C3%AB-Lart%C3%AB-t%C3%AB-Drejt%C3%ABsis%C3%AB.pdf>

5.2 Komandime nga KLP

Gjatë vitit 2021, me vendimet nr. 18, datë 27.01.2021, nr. 19, datë 27.01.2021, nr. 20, datë 27.01.2021 dhe vendimin nr. 21, datë 27.01.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë janë komanduar për një periudhë 5 vjeçare, katër magjistratë të profilit prokurorë, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për një inspektor magjistrat, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare, për shkak të vendimit të shkarkimit nr. 426, datë 27.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK). Aktualisht rasti është në procedurë pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA). Një inspektor tjetër magjistrat, ka përfunduar procesin e rivlerësimit dhe është konfirmuar në detyrë dhe dy magjistratët e tjerë, nuk i janë nënshtruar ende procesit të rivlerësimit kalimtar.

5.3 Rekrutimi i inspektorëve jomagjistratë

Gjatë vitit 2021 janë përfunduar procedurat përzgjedhëse për 6 (gjashtë) pozicionet e shpallura për inspektorë jomagjistratë, nga të cilat janë plotësuar 4 (katër) pozicione.

Gjithashtu gjatë vitit 2021, në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 209 dhe 211, pika 2 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, si dhe të Urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në datë 30.09.2021 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shpallur procedurën për 9 (nëntë) pozicione vakante për inspektorë jomagjistratë, Njësia e Inspektorëve, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përcaktuar si afat për shprehje interesi datën 29.10.2021. Ky proces, referuar afateve procedurale në dispozitat e sipërcituara, parashikohet të zgjasë deri në 8 muaj.

Shpallja është bërë publike në faqen zyrtare elektronike të institucionit, në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, si dhe në standat e informimit për publikun. Pas përfundimit të afatit 1 (një) mujor për shprehje interesi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me urdhrin nr. 142, datë 29.10.2021 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, i cili në datën 08.11.2021 ka filluar procedurën përzgjedhëse duke njoftuar 19 kandidatët, të cilët kanë shprehur interes për pozicionin e inspektorit jomagjistrat, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe duke publikuar në faqen zyrtare të institucionit njoftimin mbi fillimin e procedurës përzgjedhëse.

Në vijim të procedurës përzgjedhëse në përputhje me vendimin nr. 536, datë 25.07.2019, të

Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, pas përmbushjes së detyrimit ligjor për pajisjen e kandidatëve me formularët përkatës dhe dorëzimit të formularëve të plotësuar nga kandidatët pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimeve të Inspektorëve ka vijuar me dërgimin e shkresave zyrtare pranë institucioneve përkatëse, me qëllim marrjen e informacionit, mbi të cilin do të bazohet verifikimi i plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimi i figurës e i pasurisë.

Në përfundim të procesit të mbledhjes së informacionit nga institucionet përkatëse, do të vijohet me fazat e mëtejshme të procedurës përzgjedhëse për kandidatët, që kanë shprehur interes për pozicionin inspektorë jomagjistratë, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përputhje me vendimin nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit e kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”.

5.4 Zbatimi i Ligjit “Për Shërbimin Civil” në kuadër të plotësimit dhe ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Gjatë vitit 2021, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kodit të Punës dhe ligjit organik, janë realizuar në total 16 (gjashtëmbëdhjetë) emërim/rekrutime, si më poshtë:

1	Kabineti	3 (tre) emërim Këshilltarë (1 Këshilltar është larguar në muajin shtator 2021 me dorëheqje)
2	Niveli i Lartë Drejtues	1 (një) Sekretar i Përgjithshëm
3	Niveli i Mesëm Drejtues	3 (tre) Ndhmës Inspektorë (2 lëvizje paralele dhe 1 pranim nga jashtë shërbimit civil); (1 pezullim)
4	Niveli i Ulët Drejtues	1 (një) Përgjegjës, Sektori i Auditimit të Brendshëm (lëvizje paralele);
5	Niveli Ekzekutiv	5 (pesë) Specialistë (1 lëvizje paralele, 4 pranim në shërbim civil); (Liruar me dorëheqje 3 & 1 pezullim)
6	Punonjës me Kod Pune	3 (tre) Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme

Totali i emërimeve për vitin 2021 brenda strukturës së miratuar është 24 punonjës/nëpunës.

Numri i punonjësve sipas strukturës për vitin 2021 është 93 punonjës të miratuar. Totali është 72 punonjës që ushtrojnë efektivisht detyrën, nga të cilët 64 punonjës brenda strukturës së miratuar dhe 8 punonjës me kontrata të përkohshme.

Me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e

Shërbimit Civil është kërkuar kryerja e kontrollit mbi verifikimin e ligjshmërisë së kryerjes së procedurave të rekrutimit për pozicionet e shërbimit civil që nga momenti i krijimit të institucionit.

Procesi i mbikëqyrjes është realizuar gjatë periudhës 10.06.2021-07.07.2021 në zbatim të programit të mbikëqyrjes, me nr. 655/1, datë 03.06.2021, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Në përfundim të procesit të mbikëqyrjes, për sa i takon verifikimit të ligjshmërisë të procedurave për plotësimin e vendeve vakante, pjesë e shërbimit civil, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nuk ka konstatuar parregullsi gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil dhe me vendimin nr.145, datë 17.11.2021, ka miratuar raportin përfundimtar.

5.5 Veprimtari në kuadër të rritjes së kapaciteteve

Gjatë periudhës janar 2021-dhjetor 2021, janë kryer dhe ndjekur trajnime me qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive profesionale, me fokus të veçantë njësinë e inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve për zhvillimin profesional, në përmbushjen sa më eficiente të detyrave funksionale.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka treguar një vëmendje të veçantë, lidhur me rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke i dhënë prioritet zhvillimit të trajnimeve nga ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë, që nga krijimi i institucionit.

Zhvillimi i këtyre trajnimeve në vazhdimësi, shihet si një element shumë i rëndësishëm për rritjen e performancës, jo vetëm të njësisë së inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve, por edhe të gjithë stafit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Konkretisht Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, deri tani ka patur bashkëpunime me organizata ndërkombëtare si TAIEX, OPDAT, CEPEJ, Misioni EURALIUS V..etj, dhe me Aspa-n, si më poshtë:

Misioni i ekspertëve të BE, TAIEX:

- Trajnimi me temë “*Mbi çështjet disiplinore ndaj magistratëve.*” Ky trajnim u organizua në datën 25.02.2021, me pjesëmarrjen e inspektorëve, kabinetit, ndihmësinspektorëve dhe drejtuesve të administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe përfaqësues të Këshillit të Përgjithshëm të Shërbimit të Inspektimit të Gjyqësorit dhe Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme të Spanjës.

Misioni OPDAT:

- Trajnimi me temë “*Vlerësimi i sjelljes së papërshtatshme të magistratëve, një këndvështrim nga gjyqësori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës*”. Ky trajnim u organizua më datë 22.04.2021 me pjesëmarrjen e njësisë së inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve të Zyrës së

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe znj. Leslie Ann Gerardo, e Zyrës së Përgjegjësisë Profesionale të Departamentit të Drejtësisë në SHBA.

- Trajnimi me temë “*Vlerësimi i sjelljes së papërshtatshme të magjistratëve, një këndvështrim nga gjyqësori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës*”. Ky trajnim u organizua më datë 27.05.2021 me pjesëmarrjen e inspektorëve, ndihmësinspektorëve dhe z. Christian Kennerly, Këshilltar Ligjor pranë Sekretarisë Gjyqësore të Gjykatës së Apelit, Qarku i Njëmbëdhjetë, në SHBA.

Misioni EURALIUS V:

- Trajnimi me temë “*Sistemi disiplinor në një këndvështrim të përgjithshëm*”. Ky trajnim u organizua në muajin Shkurt 2021, me pjesëmarrjen e inspektorëve të rinj magjistratë e jo magjistratë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe drejtueses së projektit Dr. Agnes Bernhard dhe ekspertin ndërkombëtarë zj. Anita Mihailova.

- Trajnimi me temë “*Sistemi disiplinor në një këndvështrim të përgjithshëm*”. I organizuar më datë 03.03.2021 në këtë trajnim morën pjesë ndihmës inspektorët e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe ekspertë të Misionit Euralius V.

- Trajnimi me temë “*Hetimi disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve*”. Ky trajnim u organizua në datat 16-17.04.2021 me pjesëmarrjen e inspektorëve, ndihmës inspektorëve dhe kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjatë trajnimit u trajtuan specifika të punës përgatitore përpara fillimit të një hetimi disiplinor, interpretime të ligjit, sjellja e magjistratit, si dhe zbatimi i dispozitave kushtetuese gjatë periudhës tranzitore për shkak të vakumit ligjor..etj.

- Trajnimi me temë “*Hetimi disiplinor në Shqipëri.*” Ky takim u organizua në datën 27.05.2021 me pjesëmarrjen e administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

- Trajnimi me temë “*Inspektimet tematike dhe inspektimet e gjykatave dhe prokurorive*”. Ky trajnim u organizua në muajin Maj 2021, në qytetin e Korçës, me pjesëmarrjen e inspektorëve, ndihmës inspektorëve, këshilltarë të kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe përfaqësues të misionit OPDAT.

Projekti CEPEJ:

- Trajnimi me temë “*Inspektimet gjyqësore, praktika të mira nga Inspektoratet Evropiane të Drejtësisë*”. Ky takim u organizuar në muajin Nëntor 2021, dhe morën pjesë njësisia e Inspektorëve, ndihmës Inspektorëve dhe kabineti i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me katër trajnerë-ekspertë, inspektor magjistrat, Delphine Agouet and Sylvie Merges, nga Inspektorati i Lartë të Drejtësisë, Francë; Emanuela Aliverti nga Inspektorati i Drejtësisë, Itali dhe Nicoleta Rhfir nga Inspektorati i Drejtësisë, Rumani.

Rritja e kapaciteteve dhe zhvillimi profesional ka vazhduar edhe për nëpunësit civilë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke ndjekur trajnime pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nëpunësit civilë të çdo niveli, në përputhje me detyrat funksionale, gjatë vitit 2021, kanë ndjekur 475 trajnime.

VI. TË DHËNA MBI PROCESET GJYQËSORE KU INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ËSHTË PALË NDËRGJYQËSE.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë deri më 31 dhjetor 2021, ka qenë palë e proceseve si më poshtë:

Procese pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit:

1. Çështja e juridiksionit disiplinor, nr. 3 datë 30.04.2021, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është thirrur me cilësinë e subjektit të interesuar, bashkë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me kërkues magjistrat, pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, me objekt: Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për caktimin e masës disiplinore ndaj prokurorit”. Statusi i çështjes gjyqësore është në proces.
2. Çështje të juridiksionit disiplinor, nr. 2, datë ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është thirrur me cilësinë e subjektit të interesuar, bashkë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, me paditës magjistrat pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me objekt: Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Lartë gjyqësor, “Për caktimin e masës disiplinore ndaj një magjistrati dhe rivendosja e të drejtave të kufizuara të kësaj vendimmarrje”. Statusi i çështjes gjyqësore është në proces.

Procese gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë:

1. Çështje gjyqësore, me palë paditëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë me palë të paditur Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me objekt padie: “Shfuqizim/paligjshmëri akti administrativ, ndaj një vendimi të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me anë të së cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedimin disiplinor të një magjistrati dhe zgjidhjen e pasojave të paligjshmërisë, pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe caktimin ndaj magjistratit të masës disiplinore “Vërejtje publike”, të parashikuar nga neni 105, paragrafi 1, shkronja “b” dhe neni 107 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “dh” e ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, ose detyrimin e KLP të vendosë ndaj magjistratit masën disiplinore “Vërejtje publike”, të parashikuar nga neni 105, paragrafi 1, shkronja “a” dhe neni 107 i ligjit nr. 96/2016, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “dh” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka vendosur: “Pranimin pjesërisht të padisë së palës paditëse”, duke shfuqizuar vendimin e KLP-së dhe rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera. Statusi i çështjes gjyqësore rezulton i përfunduar.

2. Çështje gjyqësore ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka qenë palë e paditur me palë paditëse magjistrat, me objekt padie: Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për pezullimin nga detyra të një magjistrati pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”; dhe vazhdimin e ushtrimit të detyrës pranë kësaj gjykate” Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka vendosur: “Rrëzimi i padisë si të pabazuar në prova e në ligj.”. Statusi i çështjes gjyqësore rezulton i përfunduar.

Procese gjyqësore në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Tiranë:

1. Çështje gjyqësore ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka qenë palë e paditur me palë paditëse kandidat i skualifikuar në kuadër të procedurës së rekrutimit për pozicionin e inspektorit jomagjistrat, pranë Zyrës së Inspektori të Lartë të Drejtësisë, me objekt padie: “Shfuqizimin e aktit administrativ të Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka vendosur: “Rrëzimin e padisë së paditësit”. Statusi i çështjes gjyqësore rezulton i përfunduar.
2. Çështje gjyqësore ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka qenë palë e paditur me palë paditëse kandidat i skualifikuar në kuadër të procedurës së rekrutimit për pozicionin e inspektorit jomagjistrat, pranë Zyrës së Inspektori të Lartë të Drejtësisë, me objekt padie: “Shfuqizimin e aktit administrativ të Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka vendosur: “Rrëzimin e padisë së paditësit”. Statusi i çështjes gjyqësore rezulton i përfunduar.

VII. NEVOJA PËR NDRYSHIM NË KUADRIN LIGJOR QË RREGULLON VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT.

Në vlerësim të përvojës 2-vjeçare nga ngritja e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mbetet sfida e vazhdueshme, plotësimi i vendeve vakante për inspektorë, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme nga ana jonë për përthithjen e kapaciteteve të profilit magjistrat. Për këtë i referohemi kërkesave të vazhdueshme drejtuar KLGJ-së për shpallje të vendeve vakante, por në përfundim të tyre procedurat e zhvilluara kanë rezultuar, jo vetëm pa komandime, por pa pasur asnjë kandidat të interesuar për pozicionin inspektor magjistrat.

Në një vlerësim të kryer nga ana jonë, disa nga problematikat e evidentuara më poshtë diktojnë nevojën për zgjidhje.

Fillimisht, afati i përlllogaritur për kohën mesatare që nevojitet për plotësimin e një kërkesë për komandim nga këshillat, nga momenti i paraqitjes së kërkesës së ILD-së deri në vendimmarrjen përkatëse rezulton se koha mesatare e afati për komandimin e një magjistrati mund të variojë deri në 12 muaj. Përlllogaritja është bazuar mbi afatin e depozitimit të kërkesës nga ILD 29.01.2020 dhe marrjes së vendimit nga KLP (08.02.2021) për komandimin e magjistratëve përkatës.

Po kështu, edhe rekrutimet për pozicionet inspektorë jomagjistratë, kanë rezultuar procese të gjata e të shtrira në kohë, të cilat në bilanc të punës në një vit veprimtari, ndikojnë në rezultatet e arritura për atë vit, duke i shtrirë efektet e tyre, edhe për vitet në vijim.

Duke reflektuar në retrospektive, gjatë realizimit të procedurës fillestare për rekrutim të inspektorëve jomagjistratë, koha mesatare për zhvillimin e procedurës sipas kësaj thirrje ka qenë nga shkurt 2020-janar 2021, pra rezulton të jetë 11 muaj. Për periudhën e zgatur, kanë ndikuar disa faktorë të jashtëm, jo të lidhur me veprimtarinë e ILD-së, siç ishte shpallja e gjendjes së emergjencës për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 dhe karantina si mjet për parandalimin e përhapjes së saj, por edhe faktorë të brendshëm si mungesa e mjediseve të punës, posteve të punës, baza logjistike dhe materiale, mungesa e punonjësve, ku gjatë zhvillimit të procedurave rezultonin vetëm 4 të punësuar dhe titullari. Ndryshe nga sa është vlerësuar të jetë ecuria e afateve detyruese të përcaktuar në aktet nënligjore, që normojnë këtë procedurë, ky afat rezulton të jetë mesatarisht nga 6 deri në 8 muaj, nga njoftimi i shpalljes deri në përfundim të saj me renditjen e kandidatëve.

Për shpalljen e parë në vitin 2020, prej 6 vakancave për pozicionin inspektor jomagjistrat, nga të dhënat e administruara rezulton se për këtë pozicion kanë konkurruar 30 kandidatë, 9 prej të cilëve janë tërhequr nga kandidimi, në faza të ndryshme të procesit, ndërsa në bazë të procedurave të verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kritereve ligjore për lejimin e kandidimit, 11 prej kandidatëve kanë rezultuar të jenë në kushtet e ndalimit të kandidimit e për pasojë, u është njoftuar vendimi i ndalimit të kandidimit, duke i rrezuar si kandidatura. Sa i takon 10 kandidatëve të tjerë, që ishin në procedurë është lejuar kandidimi për pozicionet e shpallura, duke vijuar me procedurën vlerësimi dhe pikëzimit, në përfundim të së cilës janë renditur kandidatët që kanë marrë mbi 70% të pikëve. Në përfundim të procedurës janë

emëruar vetëm 4 kandidatë të cilët kanë përmbushur kushtet dhe kriteret e vendosura për atë pozicion.

Në analizim të procedurave të nisura, në shtator të vitit 2021, për shpalljen e 9 vendeve vakante për pozicionin inspektor jomagjistrat, nga procedurat e shpalljes dhe interesit të shfaqur, raporti rezulton të jetë 1:2, ku për një vend vakant kanë pasur interes dy kandidatë. Ky raport është tregues për një numër të ulët aplikimesh që në shpallje, duke shtuar këtu edhe ecurinë e procedurave, respektimin e afateve dhe gjetjet e organeve kompetente, rastet e tërheqjes nga kandidimi dhe renditjes e pikëzimit, janë faktorë të cilët kanë ndikim në rezultatet përfundimtare, e për pasojë në rezultatet e rekrutimit dhe fillimit efektivisht të detyrës.

Pavarësisht përpjekjeve të ILD-së edhe KLGJ-së për të komanduar magjistratë janë vlerësuar si të nevojshme ndërhyrjet ligjore, me synim rritjen e prurjeve nga radhët e magjistratëve.

Në vlerësim të analizës së mësipërme, përpjekjeve të ILD-së edhe KLGJ-së për të komanduar magjistratë dhe kushtet aktuale të kuadrit ligjor për plotësimin e vendeve vakante, për një institucion të ri mbetet një sfidë e vazhdueshme, e cila kërkon ndërhyrje në nivel ligjor, për të adresuar çështje si kriteret e hyrjes, barazimi i trajtimit financiar për inspektorët jomagjistratë në krahasim me inspektorët magjistratë, përmirësimi i kushteve të punës. Qasja për të adresuar problematikën e rekrutimeve duhet të jetë në baraspeshë dhe raport të drejtë me faktorët që kanë ndikuar në përvojën e vitit të kaluar me rekrutimet, por edhe faktorët që priten të ndikojnë në procedurat e shpallura në shtator 2021. Me qëllim adresimin e situatës, kërkohet bashkërendim i punës me organet kompetente²² për të:

- Rishikuar kriteret që duhet të përmbushin magjistratët për t'u komanduar në detyrën e inspektorit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke reduktuar vitet e përvojës në funksion;
- Komandim të përkohshëm të magjistratit që ka paraqitur kërkesë, deri në kryerjen e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës, ose shkurtimin e afateve për paraqitjen e kërkesave dhe përgatitjen e opinionit nga këshillat;
- Heqjen e kriterit për të pasur numër të barabartë inspektorësh magjistratë dhe jomagjistratë;
- Trajtim të barabartë financiar për inspektorët jomagjistratë;

Me bindjen se ndryshimet ligjore priten të ofrojnë mundësinë e plotësimit të kriterëve nga një numër më i lartë magjistratësh, me synim reduktimin e kriterëve hyrëse, për të nxitur kandidaturat nga radhët e magjistratëve, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, hartoi kërkesën e detajuar, duke justifikuar qëllimet dhe nevojën e ndryshimeve në respektim të kërkesave dhe procedurës së parashikuar nga ligji nr. 9000/2003 “Për organizmin dhe funksionin e Këshillit të Ministrave”, duke përcjellë projekt aktet dhe relacionet përkatëse shoqëruese, për ndryshimet e kërkuara, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. 2922 prot., datë

²² Të gjitha organet kompetente në vlerësimin e kërkesës për ndryshime ligjore, duke filluar me kërkesën drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, përcjelljen më tej për miratimin e propozimit pranë Këshillit të Ministrave dhe miratimin përfundimtar të tij nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

02.12.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ndryshimet e propozuara nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk u morën parasysh nga Ministria e Drejtësisë dhe deri në momentin e hartimit të këtij raporti, nuk ka një përgjigje nga kjo Ministri ndaj propozimit të ILD-së për ndryshime ligjore.

Si pasojë e mungesës së një përgjigje, propozimet iu adresuan Kuvendit si draft amendamente të:

- ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe
- ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Konkretisht:

Amendimet e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, kishin lidhje me njësimin e masës së shpërblimit për inspektorët magjistratë dhe jomagjistratë, si dhe me pasqyrimin në dosjen përkatëse të hetimit disiplinor, të opinionit të inspektorit përgjegjës të ngarkuar me hetimin, në rastin e një mendimi të ndryshëm me vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Propozimet merrnin në konsideratë edhe frymën e ndryshimeve kushtetuese, sa i takon natyrës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili është parashikuar të funksionojë si një organ monokratik dhe i centralizuar. Tjetër çështje që duhej adresuar nëpërmjet ndryshimeve ligjore në propozuara, lidhej me garantimin e funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet plotësimit të vakancave të pozicioneve për inspektorë. Ndryshimet propozonin heqjen e kufirit të raporteve të inspektorëve magjistratë dhe atyre jomagjistratë. Me qëllim që të sigurohet funksionaliteti i institucionit dhe përmbushja e kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore, propozimi i lë përparësi komandimit të magjistratëve, por nuk kufizon plotësimin e trupës së inspektorëve, në rastin kur magjistratët nuk paraqesin interes për t’u përfshirë në procedurat e komandimit.

Amendimet e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” lidheshin me kufizimin e vendosur në dispozita për inspektorë që vinin nga radhët e magjistratëve. Për këta kërkohej, që për t’u komanduar inspektorë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duhet të plotësonin kushtet për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë ose në Prokurorinë e Përgjithshme. Kushti i referohej viteve të ushtrimit të funksioneve si magjistrat, (jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta). Për sa më lart, duke vendosur në balancë nevojën për garantimin e një standardi të lartë në procesin e hetimit disiplinor (i cili nuk është domosdoshmërisht i lidhur me vitet e qëndrimit të magjistratit në sistem) nga njëra anë dhe nga ana tjetër mbrojtjen e interesit publik dhe reputacionit të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë në tërësi nga veprimet që çënojnë dhe dëmtojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, propozuam ndryshimin e kriterëve të komandimit të magjistratëve në pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke parashikuar mundësinë e komandimit në këto pozicione të magjistratëve, që plotësojnë kriteret për t’u ngritur në detyrë, në pozicione pranë gjykatave apo prokurorive të shkallës së dytë.

Gjatë ndjekjes me interes të ecurisë së procesit të shqyrtimit të propozimeve ligjore sipas procedurave parlamentare nga komisionet përgjegjëse, u njohëm me kalendarin e punimeve, sipas të cilit projektligjet ishin vendosur për shqyrtim në datën 06.04.2021. Pavarësisht datës së caktuar në kalendarin e punimeve të komisioneve, nga verifikimet e kryera në faqen zyrtare të Kuvendit, për periudhën 06.04.2021, deri në dhjetor 2021, rezulton se nuk ka të publikuar asnjë procesverbal të komisionit përgjegjës apo komisionit për dhënie mendimi, mbi shqyrtimin e nismës së një ish-deputeti për projektligjin nr. 115/2016.

Në këto kushte, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, nevoja e ndryshimeve ligjore, nën dritën e argumenteve të parashtruara më lart, mbetet një prioritet për vitin 2022.

VIII. TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN.

8.1. Transparenca në fokus të veprimtarisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur në fokus të punës së tij, transparencën me publikun dhe median, si parakusht për një vendimmarrje në përputhje me pritshmëritë për institucionet e reja të sistemit të drejtësisë. Marrëdhënia me publikun është konceptuar si një nga mënyrat më efektive, jo vetëm për të garantuar besimin e publikut tek ILD në vecanti, por edhe tek drejtësia në përgjithësi.

Për të përmbushur rekomandimet që rrjedhin nga Rezoluta e Kuvendit, në lidhje me rritjen e ndërveprimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qytetarët, janë ndërmarrë hapat e duhura, që kanë rritur transparencën e institucionit në mënyrë domethënëse në sytë e publikut.

Faqja zyrtare e internetit, përcjellja e informacionit të qartë për funksionet e ILD-së e për procesin e ankimimit, pritja e qytetarëve, informimi publik, mënyrat për të arritur tek publiku dhe komunikuar me të janë mjetet për të ofruar në dinamikë transparencën, si mënyrë pune në ILD.

Për të lehtësuar maksimalisht procesin e paraqitjes së ankesave nga qytetarët, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, publikoi një formular më të thjeshtuar, përmes të cilit qytetarët apo edhe institucionet, mund të paraqesin shkelje të dyshuara nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Po në kuadër të transparencës, për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas orientimit që jepet në faqen e internetit për procesin e ankimimit, është evidentuar adresa email dhe numri i telefonit në dispozicion të publikut, që është funksional gjatë orarit zyrtar. Nga ana tjetër, ekipi i zyrës së ankesave realizon pritje me qytetarët çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00


8.2. Faqja e internetit si mënyrë komunikimi e institucionit

Faqja zyrtare e internetit www.ild.al mundëson qasje në kohë reale, në shqip dhe anglisht me informacionin dhe përmbush detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Përmes faqes së internetit, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vendosur marrëdhënie proaktive, transparente e informuese me publikun dhe median. Kjo është arritur përmes ristrukturimit të faqes, sipas konceptit e gjithë vëmendja tek publiku, me një dizajn të ri, i cili krijon lehtësi për çdo qytetar apo subjekt të interesuar, në kërkimin e informacionit në kohë reale. Një video informuese 84 sekonda e publikuar në faqe, përmbledh rolin, funksionet dhe ankimimin pranë ILD-së. Krahas prezantimit mbi rolin, funksionet, kompetencat, buxhetin dhe strukturën organizative të ILD-së, faqja e internetit përditësohet me informacion në kohë reale dhe të thjeshtë për t’u asimiluar për publikun, nëpërmjet rubrikave të dedikuara për vendimet, raportet mbi veprimtarinë e institucionit, ankesat, njoftimet për media, buletinet informuese periodike, monitorimet e buxhetit, aktivitetet dhe çdo e dhënë statistikore në lidhje me vendimmarrjet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Faqja zyrtare www.ild.al, i ka kushtuar vëmendje të dedikuar ankuesve. Në pjesën më të dukshme të saj është vendosur rubrika “*Si pranohen ankesat*”, në të cilën gjendet informacion i thjeshtuar, se si mund të ankoresh pranë ILD-së. Rubrika e sipërcituar përmban formularin *tip* të ankesës, së bashku me udhëzimet e thjeshtëzuara, mbi mënyrën se si duhet plotësuar, depozituar dhe afatet përkatëse. Në funksion të transparencës dhe lehtësim të mëtejshëm të paraqitjes së një ankesë, në këtë rubrikë janë publikuar një sërë shembujsh mbi vendimet që merr Inspektori i Lartë i Drejtësisë për raste të pranimit të ankesave. Shembujt ndihmojnë cdo person të interesuar, që ankesa plotëson kushtet e vendosura nga ligji për të qenë e pranueshme. Për një informim edhe vizual, në rubrikën “*Si pranohen ankesat*” është publikuar “*Harta e Ankesës*”, një ilustrim grafik i rrugës që ndjek ankesa në ILD, që prej fazës së parë të shqyrtimit deri kur përfundon në vendimarrje.

Procesi i administrimit e përpunimit të ankesave në ILD, ofrohet si informacion në shifra në faqen zyrtare. Çdo të hënë bëhet freskimi i shifrave të publikuara, bazuar në punën e kryer javën paraardhëse, mbi numrin e ankesave të administruara, ankesave të trajtuara, ankesave në proces trajtimi, ankesa në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar, vendime për fillim hetimi disiplinor dhe kërkesa për procedim disiplinor.

Të gjitha këto hapa cilësorë janë ndërmarrë në kuadër të rritjes së ndërveprimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me publikun.



Me qëllim thjeshtimin e të kuptuarit të ecurisë së ankesave, është konceptuar “*Harta e ankesës*”, e cila pasqyron për publikun rrugën që ndjek ankesa në institucion, nga momenti i dorëzimit, protokollimit, deri në pasqyrimin e fazave që ndiqen për verifikimin e rastit, nëse konstatohen shkelje disiplinore të magistratit. Përveç ‘Udhëzuesit’ të miratuar për plotësimin e formularit të ankesës, në rubrikën “*Si pranohen ankesat*”, në faqen zyrtare të internetit janë publikuar shembuj konkretë të plotësimit të formularit të ankesave.

8.3 Pritja e qytetarëve në mjediset e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Sektori i Ndhmës Juridike dhe Ankesave në ILD realizon pritje me qytetarët në çdo ditë jave, nga ora 09.00-14.00. Gjatë vitit 2021, pranë Zyrës së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, janë ndihmuar në lidhje me pretendimet/ankimet e tyre për magjistratët, mesatarisht 4 (katër) qytetarë në ditë.

Konkretisht:

- Janë realizuar 185 takime me qytetarë, (mbi bazën e kërkesave me shkrim, të kërkesave më anë të komunikimit me telefon, si dhe pa përcaktim të mëparshëm). Gjatë takimeve, në çdo rast nëpunësit përgjegjës kanë dëgjuar pretendimet, duke i asistuar/informuar për paqartësitë, në lidhje me të drejtat e qytetarëve për t'u ankuar.
- Janë asistuar përmes telefonit, në numrin zyrtar të institucionit 313 qytetarë/subjekte të interesuar, të cilët kryesisht kanë kërkuar informacion mbi fazën në të cilën ndodhen ankesat, mënyrën se si pranohen, si procedohet me paraqitjen e dokumenteve shtesë në mbështetje të pretendimeve të tyre, etj.
- Nëpërmjet përgjigjeve zyrtare me shkrim ose postës elektronike, 234 qytetarë/subjekte, kanë marrë informacionin e kërkuar, brenda një afati të shkurtër kohor.



8.4 E drejta e informimit

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka përmbushur në çdo rast përpara afateve detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, dhe nga miratimi i Programit të Transparencës të rishikuar, dhe plotësimit të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve sipas urdhërimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Informacioni i bërë publik në programin e transparencës, pasqyron në

mënyrë shteruese veprimtarinë e ILD-së, nëpërmjet publikimit të detajuar në faqen zyrtare www.ild.al, si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyron në rubrika, tekste/përmbajtje, afate të përcaktuara kohore për bërjen publike të informacionit, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet qartë vendndodhja e informacionit zyrtar në hartën e faqes së internetit dhe përditësimi, si në formë dhe përmbajtje.

Gjatë vitit 2021, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur 114 kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda afateve ligjore. Asnjë kërkesë nuk rezulton të jetë ankuar në autoritetet përkatëse për: a) mungesë informacioni; b) informacion të paqartë; c) tejkalim të afateve ligjore dhe ç) refuzim të dhënies së informacionit.



Krahasuar me të dhënat e vitit paraardhës konstatohet një rritje sasiore dhe cilësore e trajtimit të kërkesave për informacion. Duke e konsideruar tregues progresiv të rritjes së besimit të publikut tek institucioni, administrata e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, ka trajtuar brenda një harku të shkurtër kohor kërkesat për informacion nga qytetarët, media, grupet e interesit apo organizatat e shoqërisë civile. Mesatarisht për vitin 2021 është trajtuar një kërkesë për informacion (pavarësisht volumit), për çdo dy ditë pune. Referuar të dhënave publike, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për vitin 2021, ka trajtuar 114 kërkesa për informacion.

8.5 Mënyrat e komunikimit me publikun

Duke vendosur si prioritet kryesor në veprimtarinë institucionale transparencën ndaj publikut dhe medias, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka ndërmarrë disa hapa cilësorë me qëllim rritjen e besimit tek çdo aktor publik, mediatik apo grup interesi:

- Faqja zyrtare www.ild.al ka informacion të plotë, të përditësuar në variant dygjuhësh, shqip dhe anglisht.
- Një material audiovizual 84 sekondësh, i publikuar në faqe prezanton rolin, funksionet dhe ankimimin në ILD.
- Adresa zyrtare e postës elektronike, info@ild.al shërben si mjet komunikimi i thjeshtëzuar për dërgimin e ankesave/dokumenteve, duke i garantuar publikut aksesin e nevojshëm për të lehtësuar komunikimin me Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- Për t'i mundësuar në kohë reale komunikimin publikut dhe grupeve të interesit, pranë ILD-së, funksionon numri zyrtar i telefonit, përmes të cilit garantohej e drejta për informim.
- Sektori i Ndihmës Juridike dhe Ankesave, si strukturë përbërëse e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, pret (çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00) qytetarët, që kanë nevojë për asistencë në plotësimin e formularit TIP të ankesës dhe udhëzon ata në plotësimin e tij.
- Buletini mujor i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson publikut qasje të plotë me përmbledhjen periodike informuese mbi veprimtarinë e ILD. Një sesion i veçantë i dedikohet ankimimit në ILD dhe statistikave të prodhuara nga zyra për ankesat. Buletini mujor vjen në versionin online në shqip e anglisht dhe është lehtësisht i aksesueshëm në faqen zyrtare.
- Llogaria zyrtare e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në aplikacionin Twitter, shërben si mjet komunikimi me ndjekësit dhe përdoruesit e këtij aplikacioni.
- Për të mbërritur vizualisht tek publiku, ILD ka hapur kanalën zyrtarë në Youtube, ku publikohen aktivitetet video të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

8.6 Komunikimi me median si mënyrë për të arritur tek publiku

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vendosur një marrëdhënie bashkëpunuese me mediat, si ndërmjetëse me opinionin publik, duke informuar në kohë reale mbi veprimtarinë e institucionit. Për të rritur transparencën por edhe ofruar informacion të targetuar mbi punën e institucionit, çdo fillim muaji në faqen zyrtare të internetit publikohet 'Buletini mujor', (janë botuar gjithsej 11 Buletine për vitin 2021), i cili përveç aktiviteteve e ecurisë së punës në ILD është i fokusuar në veprimtarinë mujore në lidhje me ankesat. Për këtë buletin prodhohen statistika mujore nga procesi i ankimimit. Gjithashtu, janë publikuar 64 njoftime, intervista, takime dypalëshe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me aktorë kombëtarë e ndërkombëtarë, mesazhe sensibilizuese, tryeza të rumbullakëta me grupet e interesit, me fokus informimin e plotë e transparent të publikut dhe mediave. Vëmendje e veçantë i është kushtuar monitorimit të mediave, me qëllim vjeljen e informacionit në kohë reale mbi denoncimet e ndryshme, për rastet e shkeljeve të pretenduara disiplinore të magjistratëve.

IX. PERFORMANCA FINANCIARE

Për vitin 2021, me ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë iu planifikua një buxhet prej 260 milionë lekë, nga i cili:

1. Shpenzime korrente 208 milionë lekë
2. Investime 52 milionë lekë

Nisur nga ecuria e realizimit të tij gjatë vitit 2021, buxheti i ILD pësoi ndryshime e konkretisht:

Për grupin e shpenzimeve korrente:

Mosplotësimi i vendeve vakante për pozicionet “inspektor” krijoi fonde të lira në zërat “Paga” e “Sigurime” dhe me Aktet Normative nr. 26, datë 22.06.2021 dhe nr. 34, datë 03.12.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, ky buxhet pësoi një reduktim prej 75.9 milionë lekë.

Investimet sipas projekteve të miratuara:

- Për projektin “Rikonstruksion i ambienteve të godinës së ILD”, në ligjin vjetor të buxhetit 2021, u planifikua fondi në vlerën 32 milion lekë. Me përfundimin dhe dorëzimin nga zyra projektuese të Projekt Preventivit për Rikonstruksionin e Godinës së ILD-së, u konstatua se buxheti i mbetur pas realizimit të prokurimit për hartimin e projekt preventivit arrinte të mbulonte vetëm 25% të vlerës së preventivit të llogaritur. Në këto kushte, pas miratimit në PBA 2022-2024, zbatimi i projektit u shty për t’u realizuar me buxhetin e viteve 2022 dhe 2023. Për këtë arsye, fondi i papërdorur në vlerën 28 milionë lekë u pakësua me Aktin Normativ nr. 34, datë 03.12.2021.
- Për blerje pajisje zyre, me një buxhet të miratuar në vlerën 7.3 milionë lekë; fondi i parashikuar për blerjen e pajisjeve për mobilimin e pjesshëm të zyrave nuk u realizua, pasi procedura e prokurimit u mbyll pa fitues.
- Në buxhetin e vitit 2021, me fondin e miratuar në vlerën 7.1 milionë lekë, u realizua plotësimi i nevojave të ILD për blerjen e një automjeti.
- Për vitin 2021, me buxhetin në dispozicion prej 2.9 milionë lekë, u realizua blerja e pajisjeve informatike për stafin e ri të ILD. Ndërkohë, me ndryshimet e miratuara gjatë vitit, në këtë projekt, u sigurua fondi prej 2.5 milionë lekë për blerjen e pajisjeve të dhomës së serverëve, fond, i cili nuk u realizua deri në datë 31 dhjetor 2021.

Në mbyllje të vitit 2021, realizimi i buxhetit të rishikuar të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sipas zërave të shpenzimeve dhe në total është si më poshtë:

Zërat e shpenzimeve:	Plani (000 lekë)	Fakti (000 lekë)	realizimi (%)
1. Paga	90.600	87.929	97.0
2. Sigurime	13.500	13.036	96.5
3. Shpenzime operative	26.770	21.268	79.4
4. Të tjera korente	1.380	224	16.2
5. Investime	23.700	14.090	59.4
TOTAL BUXHETI 2021	155.950	136.547	87.5

Për vitin 2021 zhvillimi i procedurave të prokurimit publik nga Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme është kryer në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe pas një ndërprerjeje procedurat e prokurimit publik të miratuara kanë filluar të zhvillohen me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” .

Referuar regjistrin të parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2021 të miratuar të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë realizuar procedurat e prokurimit publik si më poshtë:

Tabelë treguese e procedurave të prokurimit publik të realizuara për vitin 2021.

Nr.	Tipi i procedurës së prokurimit publik	Kufiri monetar referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.	Total	Kufiri monetar referuar ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.	Total
1	Kërkesë për propozim/Procedurë e hapur e thjeshtuar	Nga 800 000 lekë – 8 000 000 lekë	5	Nga 1 000 000 lekë- 10 000 000 lekë	X
2	Blerje me vlerë të vogël	Nga 100 000 lekë- 800 000 lekë	5	Nga 100 000 lekë- 1 000 000 lekë	5
3	Blerje nën 100 000 lekë	Blerje nën 100 000 lekë	11	Blerje nën 100 000 lekë	16
4	Blerje dinamike e biletave për transportin ajror	Blerje dinamike	X	Blerje dinamike	1

	TOTAL		21		22
			43		

Për procedurat në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2021 të cilat nuk u realizuan deri më datë 31.12.2021 janë parashikuar të zhvillohen gjatë vitit 2022 dhe konkretisht:

Nr.	Objekti i prokurimit publik	Koha e zhvillimit të procedurës
1	Rikonstrukcion i godinës dhe zyrave të ILD-së	Qershor 2022
2	Supervizion dhe mbikëqyrje për rikonstrukcionin e godinës së ILD-së	Gjatë vitit 2022
3	Blerje pajisje dhe mobilje zyre	Maj 2022

Njëkohësisht regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit publik për vitin 2021 është i publikuar dhe në sistemin e prokurimit publik të Agjencisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al.

X. PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE GJATË VITIT 2021.

Viti 2021, ka qenë një vit pune me ngarkesë të theksuar për shkak të mungesave në kapaciteteve njerëzore e infrastrukturore, por në sajë të objektivave të vendosura dhe të matshme, janë arritur prioritetet kryesore, për të cilat janë paraqitur të dhënat në rubrikat pararendëse të këtij raporti. Në mënyrë të përmbledhur përmendim:

- Trajtimi i ankesave dhe rritja e numrit të hetimeve dhe procedimeve disiplinore, pavarësisht mungesës prej 18 inspektorë.
- Trajtimi i ankesave të trashëguara për të ulur numrin e ankesave të akumuluar, sipas një radhe përparësie bazuar në respektim të parimit të barazisë dhe objektivitetit.
- Përcaktimi i rregullave dhe procedurave të brendshme të punës për ushtrimin e detyrave funksionale dhe miradministrimin e institucionit;
- Rritja e bashkëpunimit me aktorë ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile;
- Rritja e transparencës e veprimtarisë përmes përmirësimit dhe pasurimit të informacionit për publikun e gjerë.

XI. PRIORITETET PËR VITIN 2022

Për vitin 2022 prioritet parësor do të vazhdojë të jetë trajtimi i sa më shumë ankesave, me qëllim rritjen e besimit të publikut. Natyrisht, ky proces shihet si i pandashëm nga plotësimi me inspektorë dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë me përkushtim do të vazhdojë në këtë drejtim, në plotësimin e vakancave dhe intensifikimi i veprimtarive për ngritjen e kapaciteteve profesionale, sipas standardeve dhe praktikave më të mira nga vendet që e kanë traditë të hershme.

Inspektimet tematike në gjykatat e prokuroritë janë një tjetër prioritet në vazhdim i ILD-së, për identifikimin e zgjidhjes së problematikave, që sistemi ka sot, pa pasur qëllim në vetvete masat disiplinore ndaj magjistratëve, por për të ndihmuar që sistemi i drejtësisë të performojë sa më mirë, në shërbim të interesave të qytetarëve, duke iu përgjigjur në kohë, me drejtësi dhe paanshmëri nevojave të shoqërisë për drejtësi.

Rritja e transparenca me publikun, pasi marrëdhënia me publikun shihet, si një nga mënyrat më efektive, jo vetëm për të garantuar besimin e publikut tek institucioni në veçanti, por edhe tek drejtësia në përgjithësi.

Rishikimi i objektivave të punës dhe hartimi i një plani të ri strategjik, të shtrirë në kohë dhe sipas një metodologjie të bashkërenduar, për të shërbyer si një bazë për planifikim të përgjithshëm dhe për menaxhimin e performancës.

Konsolidimi i bashkëpunimit me Këshillat dhe organet e rivlerësimit kalimtar mbi procesin disiplinor, trajtimin në afate të arsyeshme të procedimeve.

Përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së përgjithshme dhe në veçanti, asaj verifikuese dhe inspektuese, me fokus të veçantë zhvillimit teknologjik të një sistemi të konsoliduar të menaxhimit të çështjeve.

Përpjekje të vazhdueshme me aktorët e përfshirë për realizimin e ndryshimeve ligjore të nevojshme, në përmbushje të veprimtarisë dhe rritjes së performancës.

Finalizimi i akteve në funksion të plotësisht të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit, për vitin 2021 dhe vlerësimin e nevojave për rishikim të kuadrit rregullator në varësi të nevojave që mund të paraqiten, analizave të punës apo në kuadër të rekomandimeve të organeve shtetërore dhe angazhimeve ndërkombëtare.

XII. NIVELI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2021.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në respektim të vendimeve nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj” dhe nr. 134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, si dhe bazuar në ecurinë e punës së ILD-së që nga dita e fillimit të veprimtarisë së tij si një institucion i pavarur kushtetues, ka bërë një vlerësim të detajuar të të dhënave të depozituara pranë tij nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për periudhën shkurt-dhjetor 2020.

Në seancën plenare të datës 3 qershor 2021, Kuvendi ka miratuar rezolutën “Për vlerësimin e punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2020 (shkurt-dhjetor)”, përmes së cilës janë lënë për ndjekje dhe zbatim 8 rekomandime. Me miratimin e Rezolutës, nga e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është hartuar kalendari i masave për zbatimin e rekomandimeve, janë caktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe realizimin e masave për secilin rekomandim dhe afatet përkatëse për përmbushjen e rekomandimeve. Në zbatim të vendimit nr. 134/2018 të Kuvendit janë përgatitur dhe përcjellë raportimet 4 mujore të monitorit, për secilin rekomandim.

Nga rekomandimet e lëna sipas Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në një sintezë të nivelit të zbatimit të tyre, vëmë në dijeni se:

- prej tyre janë përmbushur (rekomandimet nr. 2, 3, 4 dhe 8),
- rekomandimet e tjera janë realizuar pjesërisht dhe mbeten në proces për realizimin përfundimtar gjatë vitit 2022 (rekomandimet 1, 5, 6 dhe 7);

Për sa i takon ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe masave të marra në zbatim të tyre, informojmë në mënyrë të detajuar sa vijon:

1 *Krijimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve për procedurën hetimore, hartimin e dispozitave të hollësishme për administrimin e këtij sistemi, si dhe bërjen publik të informacionit të pjesshëm sipas përcaktimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përputhje dhe në zbatim të nenit 137 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

Në lidhje me rekomandimin nr. 1, ILD ka caktuar një grup të brendshëm pune për të bashkëpunuar me projektin Euralius, në ngritjen dhe vënien në zbatim të sistemit të brendshëm të menaxhimit të çështjeve. Zhvillimi i sistemit, ka në fokus lehtësimin e procedurave të qarkullimit të dokumentacionit dhe ruajtjen e sigurisë së të dhënave në

mbajtura në të, duke garantuar që sistemi të krijohet sipas funksioneve përkatëse, ndarjes së detyrave, dhe trajtimit të dokumentacionit në Zyrën e ILD-së.

Miratimi i rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të ILD-së, ka përcaktuar funksionet dhe kompetencat, por edhe mënyrën e qarkullimit të informacionit dhe dokumentacionit. Hapat procedurale sipas rregullores dhe ndarjes së punës në ILD, janë pikënisja për hartimin e një rregulloreje të posaçme për përdorimin e sistemit.

Gjatë vitit 2021, kanë vijuar mbledhjet për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të brendshëm, duke parë mundësitë për të shtuar rubrika në sistem, por edhe për të rritur numrin e përdoruesve. Në këtë drejtim sistemi është pajisur me licencat e nevojshme për përdorimin e sistemit me afat vlefshmërie deri në gusht të vitit 2022.

Edhe pse jo plotësisht funksional në drejtim të ofrimit të lehtësirave për të gjithë përdoruesit dhe gjenerimin e raporteve/statistikave, sistemi është duke u përdorur kryesisht nga arkiv protokollit i cili kryen veprime të regjistrimit, skanimit dhe përditësimit të dokumentacionit shkresor për ankesat, si dhe nga inspektorët dhe ndihmës inspektorët të cilët plotësojnë në sistem dokumentacionin e lidhur me një ankesë.

Në muajin dhjetor, nga ana e projektit Euralius, është bërë dorëzimi i sistemit elektronik deri në fazën që është shpjeguar më sipër, me nënshkrimin e marrëveshjes së transferimit të aseteve mes drejtueses së misionit dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë prej janarit të vitit 2022. Sistemi i brendshëm i ankesave është tanimë në pronësinë e ILD-së dhe është pjesë e inventarit të aseteve të Zyrës së ILD-së. Duke u bërë pjesë e aseteve, do të merren masa për të bërë kërkesa buxhetore pranë MFE-së me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të sistemit dhe rinovimin e licencave përkatëse, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e sistemit dhe përmbushja e qëllimeve të tij. Duke marrë parasysh se sistemi, është vendosur në përdorim në kushtet siç është dorëzuar, ka filluar puna për vlerësimin e dokumentacionit teknik për të evidentuar qartësisht informacionin e nevojshëm, në funksion të hartimit të rregullave të brendshme për përdorimin e tij.

2 Ngritjen e bazës së të dhënave për ankesat e transferuara nga ish-KLD-ja dhe të administruara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me qëllim grupimin e tyre dhe hartimin e një radhe përparësie shqyrtimi.

Pas krijimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, (1 Shkurt 2020), prej organeve të mëparshme u transferuan për kompetencë 2104 ankesa dhe praktika në faza të ndryshme trajtimi. Me marrjen e fondit është vijuar me organizimin e punës dhe miratimin e 3 urdhra të përgjithshëm për evidentimin e këtyre praktikave dhe përcaktimin e mënyrës së trajtimit me përparësi, konkretisht:

1. Urdhri nr. 66, datë 28.09.2020 “Për ngritjen e grupit të punës, për administrimin dhe kategorizimin e ankesave të dorëzuara pranë organeve kompetente gjatë periudhës kalimtare, deri në ngritje të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në zbatim të këtij urdhri, grupi i punës evidentoi të dhënat për çdo praktikë, fazën e trajtimit të tyre etj.

2. Urdhri nr. 98, datë 12.11.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për vazhdimin e trajtimit të ankesave apo praktikave të përcjella nga Këshilli Lartë Gjyqësor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Në zbatim të këtij urdhri, grupi i punës filloi me trajtimin e praktikave të përcjella nga KLGJ sipas një rendi të caktuar në urdhër.
3. Urdhri nr. 41, datë 19.02.2021 “Për shpërndarjen e ankesave të mbartura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe të administruara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në zbatim të këtij urdhri, pas rekrutimit dhe të 8 inspektorëve (magjistratë dhe jo magjistratë), u bë shpërndarja e praktikave në 4 (katër) inspektorë për trajtimin me përparësi të tyre.

Së fundmi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar urdhrin nr. 131, datë 21.09.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore, lidhur me ankesat e trajtuara pranë zyrës së inspektorit të lartë të drejtësisë për periudhën janar-gusht 2021”. Nisur nga nevoja për të pasur statistika vjetore të veprimtarisë, objekti i urdhrin nr. 131, datë 21.09.2021, është shtuar, me qëllim mbulimin e përpunimit të të dhënave statistikore edhe për muajt vijues (shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor) të viti 2021, në mënyrë që të kemi një evidentim të plotë statistikor.

Në zbatim të këtij urdhri, grupi i punës ka nisur nga puna dhe ka krijuar bazën e të dhënave për ankesat e depozituara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe të praktikave të transferuara nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, dhe të administruara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me qëllim pasqyrimin e të dhënave të sakta, lidhur me numrin e trajtimit të tyre, objekti, pretendimet e paraqitura në këto ankesa etj.

3 *Bashkërendimin e punës dhe shkëmbimin e vazhdueshëm të informacioneve me KLGJ-në, KLP-në dhe organet e rivlerësimit kalimtar, që janë përgjegjëse për sistemin e karrierës së magjistratëve lidhur me ekzistencën ose jo të procedurave disiplinore të nisura ose ankesave të depozituara pranë ILD-së për magjistratët që aplikojnë për ngritje në detyrë brenda sistemit të karrierës.*

Lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi, nga ana jonë konsiderohet i përmbushur, pasi Inspektori i Lartë i Drejtësisë shkëmben në mënyrë të vazhdueshme informacione drejtuar KLGJ-së, KLP-së dhe KPK-së. Për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit brenda afateve të kërkuara, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka caktuar personin përgjegjës për përcjelljen e informacioneve organeve të sistemit të drejtësisë për nevojat e procedurave të zhvilluara.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në çdo rast ka trajtuar me prioritet maksimal dhënien e informacionit ndaj këtyre institucioneve. Konkretisht rezultojnë të dhënat si më poshtë:

- 145 shkresa drejtuar KLGJ dhe KLP, (informacion rreth ankesave dhe trajtimit të tyre ndaj magjistratëve gjyqtarë dhe prokurorë);
- 32 shkresa drejtuar KPK (informacion rreth ankesave dhe trajtimit të tyre ndaj magjistratëve gjyqtarë dhe prokurorë);

Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u ka kërkuar, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë listat e përditësuara të magistratëve të cilët ushtrojnë aktualisht detyrën dhe magistratëve të cilëve u përfundon statusi.

KPK, nisur nga muaji nëntor 2021, dërgon informacion pranë Zyrës së ILD-se, për çdo vendimmarrje ndaj magistratëve prokurorë apo gjyqtarë, në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Vendosja e komunikimeve mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, këshillave dhe organeve të rivlerësimit, do të jetë i vazhdueshëm dhe për të siguruar përditësimin të informacionit i cili shërben reciprokisht institucioneve në kuadër të kompetencave dhe rritjes së efikasitetit për hetimin disiplinor dhe vlerësimin e magistratëve.

4 *Forcimin e marrëdhënieve institucionale me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me qëllim trajtimin në afate të arsyeshme të procedimeve disiplinore për prokurorë.*

Zhvillimi i procedimeve të para disiplinore të paraqitura nga ILD në të dy këshillat, bazuar në legjislacionin e ri të reformës në drejtësi, ka nxitur institucionet e reja, të vendosin ura komunikimi e koordinimi për të identifikuar problematikat me interes të përbashkët, që hasen gjatë zbatimit të ligjit, dakordësimin dhe koordinimin mbi zbatimin e standardeve uniforme, përmes garantimit të një procesi të rregullt disiplinor e në respekt të pavarësisë së magistratëve.

5 *Vijimin me ritme të shpejta të punës për hartimin e manualit të hetimit disiplinor, hartimin e rregullores për trajtimin e ankesave dhe metodologjisë për inspektimin.*

Për sa i takon këtij rekomandimi, është hartuar manuali i hetimit disiplinor, një kopje fizike e të cilit u është shpërndarë të gjithë inspektorëve dhe stafit administrativ të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Hartimi i këtij manuali synon të mbështesë interpretimin dhe zbatimin e një kuadri të ri ligjor, sa i përket sistemit disiplinor për gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Shqipërisë. Manuali është i ndërtuar me analizën dhe komentet e dispozitave, format standarde të ndërtuara bazuar në kërkesa të qarta të neneve të ligjit procedural për hetimin disiplinor të shkeljeve të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorë dhe mbulojnë kryesisht procedurat që duhet të ndiqen gjatë procesit disiplinor. Hartimi i këtij manuali pritet të thjeshtojë dhe përshejtojë punën e inspektorëve.

Sa i takon metodologjisë së inspektimit, ILD për shkak të numrit të pamjaftueshëm të inspektorëve dhe numrit të lartë të ankesave të mbartura, deri tani kanë nisur 3 (tre) inspektime tematike, konkretisht:

1. Vendim nr. 1 datë 11.02.2020, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave objekt “Lirimin me Kusht”.
2. Vendim nr. 37, datë 01.06.2021 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.

12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar.

3. Vendim nr. 47, datë 15.07.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: “Respektimi i kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal” për veprën penale “Të mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”.

Pas marrjes së të dhënave nga gjykatat dhe prokuroritë të përfshira në këtë inspektim tematik, dhe analizimit të tyre gjatë procedurave inspektuese të ndjekura, për inspektimin tematik për “lirimin me kusht”, janë paraqitur 2 kërkesat për procedim disiplinor në vitin 2020 dhe 1 kërkesë për procedim disiplinor gjatë vitit 2021. Ndërsa për dy inspektimet e tjera të sipër përmendura, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është në proces së analizimit të të dhënave të administruar për secilin inspektim tematik, rezultatet e të cilëve priten të dalin gjatë vitit 2022.

Në secilin prej vendimeve për kryerjen e inspektimeve tematike ILD ka miratuar edhe metodologjinë e inspektimit që do të ndiqet. Analiza e të dhënave dhe rezultateve në këto tre raste do të shërbejnë si pikënisje për fillimin e punës për hartimin e metodologjisë së inspektimit dhe planifikimit të inspektimeve.

Në secilin prej vendimeve është miratuar edhe metodologjia e inspektimit që do të ndiqet. Analiza e të dhënave dhe rezultateve në këto tre raste do të shërbejnë si pikënisje për fillimin e punës për hartimin e metodologjisë së inspektimit. Në këtë fazë të kapacitetit të burimeve njerëzore kjo masë mbetet e realizuar pjesërisht, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të inspektorëve dhe trajtimit të ankesave të prapambetura nga ish-KLD, KLGJ-së dhe atyre aktuale, por dhe të mungesës së infrastrukturës së nevojshme për realizimin e inspektimeve.

Puna e deritanishme është e fokusuar në drejtim të organizimit të disa aktivitete të cilat kanë si synim ndërtimin e një metodologjie të caktuar për realizimin e një inspektimit. Njëkohësisht në funksion të inspektimit, janë realizuar disa trajnime/workshop-e dhe janë kryer disa takime me ndërkombëtarët për të marrë eksperiencat dhe përvojat më të mira në fushën e inspektimeve.

Një tjetër aktivitet në funksion të kësaj mase, është marrja e vendimit unanim të datës 10 dhjetor 2021, nga Rrjeti Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë, për dhënien e statusit të vëzhguesit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë ka për qëllim ndarjen e praktikave të punës nga shërbimet e inspektimit në vendet evropiane, trajnime të përbashkëta, shkëmbimin e programeve me grupe inspektorësh dhe krijimin e platformave elektronike të shkëmbimit të praktikave.

Në dhjetor 2021, është zhvilluar një aktivitet me pjesëmarrjen e të gjithë punonjësve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me synim njohjen e praktikave evropiane dhe parimeve të përgjithshme rreth inspektimeve institucionale dhe tematike.

Aktualisht është duke u hulumtuar mbi metodologjitë të disa vendeve evropiane me qëllim përcaktimin e rregullave mbi mënyrën e realizimit dhe hapave procedurale që duhet të ndiqen në një proces inspektimi. Sa i takon rregullores së ankesave, po punohet për ndërtimin e një sistemi të brendshëm të qarkullimit të dokumentacionit, në vlerësim edhe të modeleve të huaja, nga institucione homologe.

6 *Vijimin me ritme të shpejta të punës për përfundimin e procedurave të rekrutimit të inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

Lidhur me këtë rekomandim me qëllim përshpejtimin e punës së transferuar nga organet e mëparshme por edhe pas konstituimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga ana e ILD-së janë marrë një sërë masash të cilat kanë mundësuar ngritjen e institucionit, por edhe plotësimin e tij me kapacitet e nevojshme njerëzore.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vijuar punën me një inspektor të vetëm, si edhe ka kërkuar komandimin e magjistratëve të tjerë pranë këshillave. Nga ana e KLGJ-së janë realizuar shtatë shpallje, për komandimin e magjistratëve gjyqtarë në pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së ILD-së, të cilat nuk kanë rezultuar të suksesshme në drejtim të plotësimit të nevojave të ILD-së. Ndërsa nga ana e KLP-së janë plotësuar 4 vende, ku me përfundimin e procedurave, janë komanduar 4 magjistratë prokurorë, për një periudhë 5 vjeçare.

Pavarësisht përpjekjeve të ILD-së edhe këshillave për të komanduar magjistratë, janë vlerësuar si të nevojshme edhe ndërhyrjet ligjore për sa i përket rishikimit të kriterëve për inspektor nga radhët e magjistratëve, për të cilin është paraqitur informacion i detajuar në rubrikën “Ndryshimet Ligjore”.

Ndodhur në këto kushte, me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i është kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, rishpallja e procedurave për kandidimin e 6 (gjashtë) magjistratëve gjyqtarë për pozicionin inspektorë pranë ILD-së. Për sa i përket, kërkesës drejtuar KLGJ-së rezulton se me vendimin nr. 572, datë 07.12.2021, të KLGJ-së, “Për rihapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, është vendosur:

- Rihapja e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- Shpallja e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për dy pozicione të lira si inspektor.

Me njoftimin e datës 07.12.2021²³, të KLGJ-së janë ftuar magjistratë që plotësojnë kushtet dhe kriteret e komandimit, për të paraqitur kërkesë për komandim, bashkë me afatet dhe

²³ <http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/Njoftim-i-dat%C3%ABs-07.12.2021-P%C3%ABr-rihapjen-e-procedur%C3%ABs-s%C3%AB-komandimit-n%C3%AB-ILD.pdf>

procedurat që do të ndiqen në vijimësi. Me njoftimin e datës 28.12.2021²⁴ së KLGJ-së, pas përfundimit të afatit për ftesën për komandim nuk u paraqit asnjë kandidaturë.

Krahas kërkesës drejtuar KLGJ-së, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, më datë 30 shtator 2021, ka shpallur thirrjen e 9 (nëntë) pozicioneve për inspektorë jomagjistratë tek njësia e inspektorëve. Shpallja është bërë publike në faqen zyrtare²⁵, në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, si dhe në stendat e informimit për publikun.

Pas përfundimit të afatit 1 (një) mujor për shprehje interesi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me urdhrin nr. 142, datë 29.10.2021 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, i cili në datën 08.11.2021 ka filluar procedurën përzgjedhëse për 19 kandidatë të cilët kanë shprehur interes për pozicionin e inspektorit jomagjistrat, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në vijim të procedurës përzgjedhëse në përputhje me vendimin nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, pas përmbushjes së detyrimit ligjor për pajisjen e kandidatëve me formularët përkatës dhe dorëzimit të formularëve të plotësuar nga kandidatët pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është vijuar me dërgimin e shkresave zyrtare pranë institucioneve përkatëse, me qëllim marrjen e informacionit, mbi të cilin do të bazohet verifikimi i plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimi i figurës e pasurisë.

Në përfundim të procesit të mbledhjes së informacionit nga institucionet përkatëse, do të vijohet me fazat e mëtejshme të procedurës përzgjedhëse për kandidatët që kanë shprehur interes për pozicionin inspektor jomagjistratë, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

7 Hartimin dhe miratimin e planit vjetor të inspektimeve institucionale e tematike dhe bërjen publik të tij në faqen zyrtare të institucionit.

Për sa i takon këtij rekomandimi, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë marrë masa për fillimin e inspektimeve tematike edhe institucionale. Për këtë qëllim Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i është drejtuar me kërkesë Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, duke kërkuar paraqitjen e tematikave apo çështjeve, të cilat mund t’i nënshtrohen inspektimit tematik apo institucional.

Në vijim të kërkesave tona, Prokurori i Përgjithshëm ka propozuar 6 çështje të cilat mund të jenë objekt inspektimi. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas një vlerësimi të kujdesshëm të tematikave të evidentuara nga Prokurori i Përgjithshëm, por edhe në analizë të Raportit të Prokurorit të Përgjithshëm “Për gjendjen e kriminalitetit për vitin 2020”, nga ku del në pah

²⁴ <http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/Njoftim-i-dat%C3%ABs-28.12.2021-Mbi-kandidimet-n%C3%AB-procedur%C3%ABn-e-komandimit-t%C3%AB-gjyqtar%C3%ABve-n%C3%AB-Zyr%C3%ABn-e-Inspektorit-t%C3%AB-Lart%C3%AB-t%C3%AB-Drejt%C3%ABsis%C3%AB.pdf>

²⁵ <https://ild.al/sq/rekrutim-inspektore-jo-magjistrate/>

mungesa e kohezionit institucional, mungesa e masave administrative apo organizative, apo aspekte të parashikimeve legjislativë. Me qëllim adresimin e çështjeve të ngritura nga Prokurori i Përgjithshëm është organizuar një takim punë dy ditor, ku është diskutuar ndërmjet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, njërive drejtpërdrejt të angazhuar me inspektimet dhe me aktorë ndërkombëtarë, për çështjet e ngritura dhe vijimin e hartimit të një plani vjetor për inspektimet. Në analizë të mundësive të burimeve njerëzore pranë ILD-së, kapaciteteve të tyre, mundësive financiare për këtë vit, ILD ka vlerësuar se është në kushte të kapacitetit të kufizuar në drejtim të burimeve njerëzore, përvojës institucionale, por edhe të mundësive financiare për të trajtuar të gjitha nevojat dhe përcaktimin e një plani. Pamundësitë objektive të evidentuara janë të kushtëzuara edhe nga numri i lartë i ankesave të mbartura, por edhe i numrit të lartë të ankesave të paraqitura.

Në vlerësim të gjithë faktorëve me impakt në realizimin e inspektimeve, është vlerësuar se mjeti i duhur për adresimin e çështjeve të paraqitura nga Prokurori i Përgjithshëm, është zhvillimi i një inspektimi tematik me objekt: “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar”.

Në funksion të realizimit të këtij rekomandimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është duke ndërmarrë disa aktivitete bashkëpunimi me aktorë ndërkombëtarë, të cilët do të asistojnë përmes praktikave më të mira në ndërtimin e një plani vjetor, në zbatim të inspektimeve të përcaktuara në ligjet e reformës në drejtësi (ligj nr. 95/2016 dhe ligjit nr. 98/2016), por edhe nga përvoja e deritanishme në funksion të trajtimit të ankesave, duke e vlerësuar në raport me metodologjinë e ndjekur nga homologët evropianë.

Vendosja e marrëdhënieve të bashkëpunimit me strukturat homologe evropiane i shërben nevojës për të kuptuar qëllimet e inspektimit dhe rreth situatës së organit të inspektuar, e më pas të vijohet me inspektime të planifikuara në përputhje me mundësitë aktuale të kapacitetit njerëzor dhe atij financiar në dispozicion. Për këtë qëllim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka finalizuar një memorandum mirëkuptimi për fuqizimin e bashkëpunimit me inspektoratin homolog në Bullgari. Në proces negociimi është edhe memorandumimi me inspektoratet homologe në Rumani dhe Itali.

8 *Promovimin dhe rritjen e ndërveprimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qytetarët nëpërmjet aktiviteteve, informimeve periodike, pasurimit informativ të faqes duke përdorur çdo kanal tjetër të komunikimit publik.*

Marrëdhënia me publikun është një nga mënyrat më efektive për të krijuar një reputacion solid të institucionit.

Marrëdhëniet me publikun kanë të bëjnë me dërgimin e mesazheve të duhura në vendin e duhur dhe njerëzit e duhur, në mënyrë informuese dhe promovuese të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për të përmbushur rekomandimet që rrjedhin nga Rezoluta e Kuvendit në lidhje me rritjen e ndërveprimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qytetarët janë ndërmarrë këto masa:

1. Ristrukturimi i faqes zyrtare të web-it. Është krijuar një dizajn i ri për të krijuar lehtësi në hulumtimin e çdo qytetari në faqe dhe për të kërkuar informacionin në kohë reale. Faqja zyrtare ild.al pasqyron çdo aktivitet në rubrikën “Njoftime”. Po ashtu, një rëndësi e veçantë i është kushtuar ankesit, i cili në rubrikën “*Si pranohen ankesat*” gjen informacion të thjeshtuar se si mund të ankohet në ILD. Kjo rubrikë përmban formularin TIP të ankesës së bashku me udhëzimet përkatëse mbi mënyrën se si duhet plotësuar ky formular. Për të rritur transparencën dhe për një qasje sa më praktike të qytetarit me ILD janë publikuar një sërë shembujsh mbi vendimet që merr Inspektori i Lartë i Drejtësisë për raste të pranimit të ankesave. Po ashtu, është publikuar dhe “*Harta e Ankesës*” për të ilustruar rrugën që ankesa ndjek në ILD që prej fazës së parë të shqyrtimit deri kur përfundon në vendimmarrje. Të gjitha këto janë ndërmarrë në kuadër të rritjes së ndërveprimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qytetarët.
2. Vlen për t’u theksuar se informacioni i përgjithshëm dhe rubrikat e faqes zyrtare janë të përkthyer në gjuhën angleze, për të ofruar më tepër akses dhe lehtësi vizitorëve të faqes që janë të huaj.
3. Është hartuar buletini mujor i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili është një përmbledhje periodike me karakter informativ mbi veprimtarinë e Zyrës së ILD. Një sesion i veçantë i është kushtuar edhe statistikave të prodhuara nga zyra mbi ankesat. Ky buletin vjen për qytetarët në versionin online.
4. Është vënë në dispozicion numri zyrtar i telefonit për lehtësimin e komunikimit me qytetarët në përputhje edhe me të drejtën e tyre të informimit.
5. Në dispozicion të qytetarëve është po ashtu edhe llogaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në aplikacionin *Twitter*, e cila shërben si mjet komunikimi me ndjekësit e këtij aplikacioni.
6. Po ashtu, për një komunikim më dinamik shërben edhe kanali zyrtar *Youtube*, në të cilin pasqyrohet çdo aktivitet mediatik i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me video.
7. Adresa zyrtare e e-mailit info@ild.al shërben si mjet komunikimi për dërgimin e ankesave por jo vetëm kaq. Me anë të postës elektronike qytetarët mund të marrin çdo informacion që i nevojitet dhe të dërgojnë çdo dokumentacion të nevojshëm për të lehtësuar komunikimin me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.
8. Sektori i Ankesave, si strukturë përbërëse e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, pret qytetarët, të cilët kanë nevojë për asistencë në plotësimin e formularit TIP të ankesës dhe udhëzon ata në plotësimin e tij.
9. Gjithashtu, është realizuar një material i shkurtër audiovizual mbi veprimtarinë e institucionit e cila është në faqen zyrtare dhe në kanalin *Youtube*.